FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 239

Tiranë – E martë, 13 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 23.11.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike".....	24359
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 7.12.2016	Për miratimin e Raportit Kombëtar për zbatimin e konventës ndërkombëtare të OKB-së "Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre".....	24359
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 846, datë 7.12.2016	Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Policisë së Shtetit për menaxhimin elektronik të gjobave (E-gjoba).....	24339
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 847, datë 7.12.2016	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Kulturës (Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori") te Bashkia Tiranë, të pronës me numër pasurie 1/53, të ndodhur në zonën kadastrale 8160, me sipërfaqe trualli dhe ndërtese 4294 m², dhe për një ndryshim në vendimin nr. 286, datë 8.8.1991, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës".....	24400
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016	Për krijimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a. dhe përcaktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive "Albpetrol" sh.a. dhe "Albgaz" sh.a.....	24402
	Korrigjim gabimi në vendimin nr. 756, datë 26.10.2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesa anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 205/2016, datë 3.11.2016.....	24403

VENDIM
Nr. 835, datë 23.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 395, DATË 29.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE DHE INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

"6. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planveprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që përcakton shpalljen për thirrjet e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit.".

2. Në pikën 7 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja "a" ndryshohet si më poshtë vijon:

"a) Dorëzimin pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Departamentit të Administratës Publike të numrit të praktikantëve për çdo thirrje.".

b) Pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) Dërgon pranë Departamentit të Administratës Publike emrat e praktikantëve që rezultojnë fitues të procesit të përzgjedhjes për çdo thirrje, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e përfundimit të këtij procesi.".

3. Pas pikës 11 shtohen pikat 11/1 dhe 11/2, me këtë përmbajtje:

"11/1. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të administrojë procesin e punësimit të praktikantëve në thirrjet e radhës, duke përcaktuar numrin e praktikantëve që do të punësohen me kontratë të përkohshme, bazuar në numrin e praktikantëve që do të kryejnë me sukses programin e praktikës, si dhe në kërkesat e institucioneve të administratës shtetërore për punësimin e përkohshëm të tyre.

11/2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i propozon Ministrisë së Financave numrin e praktikantëve që do të punësohen në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, me kontratë të përkohshme deri në një vit, për çdo institucion të administratës shtetërore.".

4. Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

"13. Fondet e nevojshme financiare për zbatimin e pikave 11/1 dhe 11/2, të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë apo institucionin buxhetor, për shpenzimet për personelin, për vitin përkatës.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 845, datë 7.12.2016

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E KONVENTËS NDËRKOMBËTARE TË OKB-së "PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË TË GJITHË PUNËTORËVE MIGRANTË DHE ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 9703, datë 2.4.2007, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare "Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre"", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Raportit Kombëtar për zbatimin e konventës ndërkombëtare të OKB-së "Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KOMITETI PËR MBROJTJEN E TË GJITHË PUNËTORËVE MIGRANTË DHE ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË TYRE
(CMW)

SHQYRTIMI I RAPORTEVE DËRGUAR NGA SHETET PALË NË MBËSHTETJE TË NENIT 73 TË KONVENTËS MBI MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË TË GJITHË PUNËTORËVE MIGRANTË DHE ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË TYRE

SHQIPËRIA
Raporti II Periodik Kombëtar
Nëntor 2016

I. HYRJE

Republika e Shqipërisë ka aderuar në Konventën "Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre" me Ligjin Nr.9703, datë 02.04.2007.

Komiteti mori në shqyrtim raportin fillestar të Shqipërisë (CMW/C/ALB/1) në takimet e tij të 138-të dhe 139-të (shiko CMW/C/SR.139 dhe SR.140), mbajtur në 22 dhe 23 Nëntor 2010 dhe miratoi vëzhgimet përfundimtare në takimin e tij të 151-të, të datës 1 dhjetor 2010.

Në raportimin e kaluar, Komiteti përshëndeste në tërësi dorëzimin e Raportit sikurse dhe përgjigjeve me shkrim të listës së çështjeve, të cilat i mundësuan Komitetit të kuptojë më mirë zbatimin e Konventës nga Shteti palë. Komiteti përshëndeste gjithashtu dialogun konstuktiv dhe frutdhënës zhvilluar me delegacionin kompetent. Në këtë Raport, Shqipëria do të raportojë mbi çështje specifike të Konventës dhe rekomandimet e kaluara të Komitetit, për periudhën 2011-2015.

Raporti i II-të periodik kombëtar, i paraqitur në zbatim të nenit 73 të Konventës për Mbrojtjen e të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre (CMW), u hartua në përputhje me Udhëzimet mbi formën dhe përmbajtjen e raporteve që duhen paraqitur nga shtetet palë, për periudhën kohore 2011 – 2015. Raporti përmban informacion mbi zbatimin e dispozitave të Konventës, rekomandimeve të Komitetit mbi Mbrotjen e të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, bazuar dhe në Vërejtjet Përmbyllëse (Dhjetor 2010). Vend të rëndësishëm zenë progresi i arritur në aspektin ligjor, institucional, politikat, vështirësitë/sfidat për garantimin e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Pas dhënies së rekomandimeve nga Komiteti, Ministria e Punëve të Jashtme ka informuar institucionet përkatëse me qëllim informimin dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve.

Duke konsideruar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si një ndër prioritetet kryesore, Qeveria shqiptare është e angazhuar në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, që rrjedhin nga konventat mbi të drejtat e njeriut. Mbështetur në Urdhrin e Kryeministrit nr.112, datë 05.03.2014 "Për ngritjen e grupit ndërministror të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", Ministria e Punëve të Jashtme koordinon procesin e përgatitjes së raporteve kombëtare mbi zbatimin e konventave për të drejtat e njeriut, përfshirë edhe raportin në kuadër të kësaj konvente, në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe institucionet e pavarura. Ky raport është hartuar si rezultat i koordinimit të punës dhe përfshirjes së institucioneve shtetërore, sipas fushave të kompetencës së tyre mbi çështjet që trajton kjo Konventë. Raporti është përgatitur në bashkëpunim me institucionet qëndrore (Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit) dhe institucionet e pavarura (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi).

II. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

1. Informacione të përgjithshme lidhur me periudhën raportuese aktuale.

1. Gjatë periudhës aktuale të raportimit mbi mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, ka pasur mjaft lëvizje dinamike të flukseve migratore (në veçanti atyre shqiptare) si dhe janë ndërmarrë masa të rëndësishme ligjore, institucionale dhe praktike për përballimin e këtyre dinamikave.

Në fushën e parashikimeve ligjore në lidhje me punëtorët migrantë dhe familjeve të tyre mund të përmenden:

2. Ligji "Për të Huajt" 108/2013 i cili garanton përmirësime lidhur me mbrojtjen sociale, për trajtimin e të huajve për të mos lejuar diskriminimin e tyre në trajtimin e të punësuarve. Në fushën e integrimit të të huajve, parashikon hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Integrimit Social të të huajve nga Ministritë përgjëgjëse. Në lidhje me Sigurimet Shoqërore u jepet mbrojtje shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, që punojnë në Shqipëri.
3. Në vitin 2014, u punua për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.818, datë 26.11.2014. Në këtë strategji janë përfshirë edhe politika për migracionin e punës për periudhën 2014-2020. Masat e planit të veprimit të kësaj strategjie kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në garantimin e mbrojtjes nga forma të ndryshme diskriminimi.
4. Ligji nr.10389, datë 03.03.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9668, datë 18.12.2006 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi". Ligji përcakton ngritjen dhe funksionimin e sporteleve të migracionit, të cilat ofrojnë shërbim informimi për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë, si dhe mbështetje për riintegrimin e emigrantëve të rikthyer.

Në fushën e marrëveshjeve dypalëshe:

5. Është në proces hartimi dhe negociimi teksti i Projekt-marrëveshjes ndërmjet Konfederatës Zvicerane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shkëmbimin e profesionistëve të rinj.
6. Në prill të vitit 2014 u nënshkrua me shtetin e Katarit "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit në lidhje me Rregulloren e punësimit të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë në Shtetin e Katarit".
7. Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2014 është punuar për vazhdimin e zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale të Republikës Italiane dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të Republikës së

Shqipërisë në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për Migracionin e Punës, nënshkruar në Korrik të vitit 2011.

8. Në Maj të vitit 2012 u nënshkrua me palën gjermane Memorandumi i Mirëkuptimit në kuadër të bashkëpunimit në projektin pilot "Triple Win Migration".

Në fushën e sigurimeve shoqërore:

9. Është në funksionim Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për mbrojtjen shoqërore", e cila ka hyrë në fuqi nga viti 2015.
10. Bashkëpunimi me Belgjikën ka nisur në mars 2010, me negociatat e para dhe ka përfunduar me miratimin e ligjit nr.35/2014, datë 3.4.2014. Marrëveshja ka hyrë në fuqi në Janar 2016.
11. Bashkëpunimi me Maqedoninë për Marrëveshjen për Mbrojtjen Shoqërore. Marrëveshja është miratuar në Këshillin e Ministrave me VKM nr 228. dt 11.03.2015 dhe u nënshkrua në Shkup në 17 Mars, 2015, nga ministrat homologë të çështjeve sociale.
12. Marrëveshja me Dukatin e Madh të Luksemburgut. Marrëveshja u ratifikua në Kuvend, me ligjin nr.42/2015, datë 16.04.2015.
13. Marrëveshja me Hungarinë është miratuar me VKM nr.531, datë 6.8.2014 dhe është nënshkruar në Tiranë në datë 10.12.2014. Aktualisht po i nënshtrohet procedurave të ratifikimit.
14. Nënshkrimi i "Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë" u realizua në Bukuresht, në 27 shkurt 2015 ndërmjet Ministrave homologë të çështjeve sociale. Aktualisht kanë filluar procedurat per dergimin e praktikes se marreveshjes për ratifikim, ne Kuvendin e Shqiperisë, përmes MPJ.
15. Marreveshja me Kanadanë ka filluar në Tetor 2013.
16. Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Është miratuar në Këshillin e Ministrave me VKM nr 727, dt 02.09.2015 dhe është nënshkruar në 23 Shtator 2015 në Tiranë. Aktualisht po përgatiten të gjitha procedurat e nevojshme për ratifikimin e saj.
17. Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Çekisë. Është miratuar në Këshillin e Ministrave me VKM nr 728, dt 02.09.2015 dhe është nënshkruar në 13 Tetor 2015 në Pragë.
18. Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë Raundi i radhës së negociatave u zhvillua në Vienë gjatë periudhës 9 – 13 nëntor 2015 ku palët parafinuan tekstin e marrëveshjes bazë si dhe ranë dakort për draftin e marrëveshjes administrative.
19. Aktualisht është në proces miratimi i vendimit të Këshillit të Stabilizim Asociimit për koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE, në zbatim te nenit 48 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.
20. Fillimi i negociatave për koordinimin e skemave të mbrojtjes shoqërore me vende të tjera si, Greqia, Kosova, Spanja, Franca, Kroacia, Danimarka.

Në fushën e luftës kundër trafikimit

21. Me Vendimin Nr. 115 datë 17.02.2016 është miratuar Plani i Veprimit për Ri-integrimin Social dhe Ekonomik të grave dhe vajzave viktima të trafikimit. Ky Plan Veprimi ndihmon në zhvillimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave VT/ VMT në fushën e fuqizimit ekonomik, p.sh. të drejtat e pronës, punësimit dhe trajnimit profesional, strehimin, arsimi dhe kujdesi social.
22. Në 19 qershor 2015, u nënshkrua Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e viktimave / viktimave t; mundshme të trafikimit. Gjatë periudhës së raportimit, takime periodike të anëtarëve të Autoritet Përgjegjës janë mbajtur, për të trajtuar raste të veçanta të viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit.

Në fushën e arsimit

23. Ligji Nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", garanton "Të drejtën për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar.

2. Informacion i përmbledhur mbi çështjet e mëposhtme

(a) Çdo nënshkrim, aderim ose ratifikim të traktateve të të drejtave të njeriut apo instrumenteve relevante ndërkombëtare për zbatimin e kësaj Konvente; në mënyrë të veçantë, çdo hapë të ndërmarrë në drejtim të ratifikimit të Konventave të ILO-s nr. 97 (1949) për Migracionin për Punësim dhe nr 143 (1975) mbi Punëtorët Migrantë;

24. Republika e Shqipërisë ka ratifikuar disa Konventa në fushën e migrimit të punës. Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) nr.97, "Migrimi për punësim", (e rishikuar) është ratifikuar me ligjin nr.9320, datë 25.11.2004. Gjithashtu është ratifikuar Konventa nr.143 Për punonjësit migrantë (dispozita plotësuese) 1975, si dhe konventa e Këshillit të Evropës "Për statusin ligjor të punëtorëve migrantë", e cila është ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr. 9555, datë 08.06.2006.

(b) Legjislacioni dhe praktika që parashikojnë mekanizma për të monitoruar situatën e migrantëve të gjinisë femërore, përfshirë edhe ato të punësuar si punëtore të brendshme, si dhe masat mbrojtëse dhe garancitë që i mbrojnë ata nga shfrytëzimi dhe dhuna;

25. IOM ka publikuar së fundmi një studim i titulluar: "Vlerësim për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë në Shqipëri", i cili është përgatitur në kuadër të kornizës së projektit "Promovimi i mundësive të mira të punësimit dhe mbrojtjen e punëtorëve emigrantë në

Shqipëri", financuar nga Qeveria e Suedisë, nëpërmjet Fondit të Koherencës "Një OKB". Gjatë përgatitjes së raportit u konsultuan konventat ndërkombëtare mbi punëtorët migrantë, veçanërisht të drejtat e grave migrante dhe çështje të tjera të ndërlidhura; legjislacioni dhe kuadri rregullator mbi emigracionin në Shqipëri, u zhvilluan takime dhe diskutime me disa aktorë kyçë, intervista individuale me grupet e interesit dhe emigrantëve në Shqipëri.[1]

26. Përveç kësaj, u diskutua me disa përfaqësues nga institucionet përgjegjëse, të tilla si Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Inspektorati Shtetëror i Punës, Gjykata e Tiranës, Gjykata Administrative e Apelit në Tiranë, Gjykata e Lartë, Prokuroria e Tiranës, Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

III. INFORMACION MBI ZBATIMIN E NENEVE TË KONVENTËS DHE REKOMANDIMET E KOMITETIT TË EKSPERTËVE TË KONVENTËS, MBI PROGRESIN E ARRITUR GJATË PERIUDHËS 2011-2015.

INFORMACION MBI NENE SPECIFIKE

- ***Informacion mbi nenin 11. Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar (Article 11- Prohibition of slavery and forced labour);***

27. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë në nenin 8 ndalon punën e detyruar në të gjitha format e saj. Me punë të detyruar ose të detyrueshme kuptohet çdo punë ose shërbim që i kërkohet individit kundër vullentit të tij, duke e kërcënuar me një dënim të çfarëdoshëm Ndalohet përdorimi i punës së detyruar si: a. masë shtrënguese ose sanksion ndaj personave që kanë ose që shprehin bindje në kundërshtim me rendin politik, ekonomik, shoqëror në fuqi; b. metodë mobilizimi ose përdorimi të fuqisë punëtore për qëllime të zhvillimit ekonomik; c. masë për disiplinën në punë; d. dënim për pjesëmarrje në grevë; e. masë diskriminimi racial, shoqëror, kombëtar ose fetar.

28. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ka ndërmarrë iniciativën për përmirësimin e Kodit të Punës në bashkëpunim dhe sipas rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Hartimi i këtij projektligji u diktua nga dinamika e zhvillimit ekonomiko-social si dhe problematika e ndeshur gjatë zbatimit të tij dhe në veçanti nga praktika gjyqësore.

[1] Studimi i plotë mund të lexohet në: http://www.albania.iom.int/publications/reports/Assessment%20of%20the%20Protection%20of%20the%20Rights%20of%20Migrant%20Workers%20in%20Albania.pdf

29. Drafti i Kodit të Punës pritet të miratohet nga Parlamenti së shpejti, i cili do të kontribuojë në përmirësimin e të drejtave dhe lirive themelore në punë, për një balancë më të mirë në marrëdhëniet midis punëmarrësve dhe punëdhënësve me qëllim shmangien e shfrytëzimit e punës dhe abuzimin me punëmarrësin.

(c) ***Informacion mbi nenet 25, 27, 28: Parimi i trajtimit të barabartë në lidhje me: pagën dhe kushte të tjera të punës dhe kushtet për punësimin: siguria sociale; e drejta për kujdes shëndetësor. - Articles 25, 27, 28: Principle of equality of treatment in respect of: remuneration and other conditions of work and terms of employment; social security; and right to receive urgent medical care;***

Ligji "Për të Huajt" 108/2013 garanton:

30. Përmirësime lidhur me mbrojtjen sociale, për trajtimin e të huajve për të mos lejuar diskriminimin e tyre në trajtimin e të punësuarve.

31. Në fushën e integrimit të të huajve, parashikon hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Integrimit Social të të huajve nga Ministritë përgjëgjëse.

32. Janë zgjeruar të drejtat e punëtorëve migrantë në drejtim të mosrevokimit dhe mosanulimit të lejes së qëndrimit për shkak të shëndetit, paaftësisë në punë pas pajisjes me leje qëndrimi, ndryshimeve në tregun e punës apo papunësisë për një periudhë të caktuar (neni 41, pikat 3,4,5 dhe nenin 42, pikat 3,4,5).

33. Revokimi dhe anulimi i lejes së qëndrimit dhe për pasojë , largimi nga territori për persona të punësuar apo vetëpunësuar nuk zbatohet për shkaqe shëndetësore apo paaftësi për punë pas përfitimit të lejes së qendrimit, ndryshimit të tregut të punës apo vështirësive financiare për shkak të ndërprerjes së punës për një periudhë të përcaktuar në ligj.

34. Në lidhje me Sigurimet Shoqërore ato u japin mbrojtje shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, që punojnë në Shqipëri.

35. Gjithashtu Punëdhënësi ka detyrimin ligjor t'i garantojë punëmarrësit:

a) kohëzgjatjen maksimale dhe minimale të përcaktuar të orarit të punës;
b) kohëzgjatjen e pushimit vjetor të paguar;
c) pagën minimale, përfshirë pagat në rritje për punën jashtë orarit;
ç) shëndetin dhe sigurinë në punë;

d) masat mbrojtëse për punën e grave shtatzëna, gratë që sapo kanë lindur apo ushqejnë fëmijët me gji, si dhe të miturit;
dh) ndalimin e diskriminimit.

- ***Informacion mbi nenin 20- Ndalimi i burgimit, privimi i dhënies së banesës, lejes së punës dhe ndalimi i dëbimit për shkak të mospërmbushjes së një detyrimi kontraktual.- (Article 20: Prohibition of imprisonment, deprivation of authorization of residence and/or work permit and expulsion merely on the ground of failure to fulfil a contractual obligation);***

36. Në nenin 71 të Ligjit për të huajt nr.108/2013 përcaktohet se, i huaji mund të punësohet në Republikën e Shqipërisë duke u pajisur me leje pune, apo me certifikatë regjistrimi pune, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, me marrëveshje ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë apo me qëndrim të njëanshëm, të shprehur me vendim të Këshillit të Ministrave.

37. Në nenin 39 të Ligjit Nr. 108/2013 për të huajt përcaktohet se Autoriteti Përgjegjës për Kufitin dhe Migracionin pajis të huajin me leje qendrimi si person i punësuar/ vetëpunësuar, në përputhje me lejen e punës.

38. Kërkesa për leje pune për një të huaj mund të bëhet nga vetë i huaji, me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, ose nga punëdhënësi.

39. Punëdhënësi ka të drejtë të bëjë kërkesë për leje pune për të huajin vetëm pasi ka publikuar për 4 javë vendin e lirë të punës, si dhe brenda kuotave të miratuara, ose për kategoritë e përcaktuara në nenin 83 të këtij ligji.Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i lejes së punës, kur plotësohen kriteret e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, bëhet brenda 30 ditëve nga dita e aplikimit.

40. Punëdhënësi nuk mund të punësojë një të huaj që qëndron në mënyrë të parregullt në Republikën e Shqipërisë. Kur punëdhënësi punëson një të huaj, duhet të njoftojë zyrën përkatëse të punësimit dhe autoritetin përgjegjës rajonal për kufirin dhe migracionin brenda 8 ditëve pas fillimit të punës së të huajit.

41. Shtetasit e një prej vendeve anëtare të Bashkimit Europian edhe zonës Shengen, që janë me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, gëzojnë të drejtën e punësimit sikurse edhe shtetasit shqiptarë, ata nuk pajisen me leje pune apo me certifikatë regjistrimi.

42. Në përputhje me Ligjin për të huajt nr.108/2013 Leja e punës për të huajin, si punëmarrës, brenda kuotave të caktuara, lëshohet duke mbajtur parasysh zhvillimet dhe nevojat e tregut të punës në Republikën e Shqipërisë, me kusht që numri i të huajve, që punojnë për një

punëdhënës, të mos tejkalojë 10 për qind të numrit të përgjithshëm të personelit në listë-pagesat për 12 muajt paraardhës.

43. Në nenin 36 të Ligjit 108/2013 Për të huajt, parashikohet e drejta e ankimimit kundër urdhrit të refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes apo anulimit të lejes së qëndrimit tek autoriteti epror i drejtpërdrejtë i autoritetit që ka nxjerrë urdhrin, si dhe në rrugë gjyqësore, sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

44. Neni 81 i Ligjit për të huajt parashikon se: Në rast refuzimi apo anulimi të lejes së punës, i huaji njoftohet me shkrim. Brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të refuzimit apo anulimit të lejes së punës, i huaji mund të ankohet me shkrim te ministri i ngarkuar me çështjet e migrimit dhe punësimit, i cili kthen përgjigje brenda 15 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

- ***Informacion mbi nenet 29, 30, 31: E drejta e fëmijës së një punëtori migrant për të patur emër, regjistrimin e lindjes dhe kombësinë; aksesi në arsimim mbi bazë e trajtimit të barabartë; respektimi i identitetit kulturor të punonjësve migrantë dhe të familjes së tyre. (- Articles 29, 30, 31: Right of a child of a migrant worker to a name, registration of birth and nationality; access to education on the basis of equality of treatment; respect for the cultural identity of migrant workers and members of their families);***

45. Dokumentet kryesore ligjore e nënligjore të hartuara nga institucionet e arsimit në Republikën e Shqipërisë dhe që i shërbejnë arsimimit integrimit të fëmijëve të punonjësve migrantë, me fokus ofrimin dhe përmirësimin e mundësive dhe shërbimeve e tyre lidhen me aspektet ligjore dhe politike që kanë të bëjnë me arsimin dhe të drejtën për arsimim.

46. Neni 5 i Ligjit Nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i cili garanton "Të drejtën për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar.

47. Neni 11 i Ligjit Nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i cili parashtron të drejtën e personave me kombësi shqiptare që jetojnë jashtë Shqipërisë për t'u arsimuar. Pranimi i tyre bëhet sipas akteve nënligjore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

48. Ligji Për të huajt parashikon që institucionet publike të bashkëpunojnë, sipas kompetencave, me partnerët socialë, organizatat jofitimprurëse dhe organizatat ndërkombëtare për promovimin dhe zbatimin e programeve të integrimit të të huajve në shoqëri.

49. Ligji parashikon gjithashtu se, në të gjitha veprimtaritë e ushtruara, institucionet publike dhe OJF-të u ofrojnë të huajve mbrojtje kundër çdo lloj forme diskriminimi. Ligji parashikon

ndalimin e diskriminimit direkt dhe indirekt nga personat juridikë, publikë dhe privatë, gjatë gjithë procesit të imigrimit për punësim.

- ***Informacion mbi nenin 37- E drejta e informimit para nisjes dhe kushtet e pranimit në një shtet, punësimit dhe pagesës së tyre (- Article 37: Right to be informed before departure of the conditions of admission to the State of employment and of their remunerated activity);***

50. Në këtë drejtim është zhvilluar një seri trajnimesh me temë *"Shërbimet orientuese për sipërmarrjen për emigrantët e kthyer dhe çështje të tjera ligjore"*, në periudhën Shtator-Nëntor 2013" Në serinë e trajnimeve u përfshinë 38 Zyra Rajonale dhe Lokale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ku u trajnuan 2-3 specialistë nga çdo zyrë, në një total prej 80 pjesëmarrësish, në lidhje me Ligjin për të huajt nr.108/2013 dhe funksionimin e Sporteleve të Migracionit.

51. Më 22 prill 2014 është zhvilluar Workshop me temë "Zyrat e punësimit dhe efikasiteti i shërbimeve për migracionin" në të cilin u përfshinë 38 Zyra Rajonale dhe Lokale të Shërbimit Kombëtar të punësimit, ku u trajnuan specialistë nga çdo zyrë dhe ku ndër të tjera janë trajtuar procedurat e pajisjes me leje pune, për shtetasit e huaj, në zbatim të ligjit "Për të Huajt".

52. Nga Zyrat e punësimit është dhënë konsulencë e vazhdueshme mbi aplikimin, dokumentacionin, kriteret dhe procedurat që ndiqen për Punësimin e të huajve në Shqipëri.

53. Eshtë dhënë konsulencë e vazhdueshme mbi mënyrat e aplikimit, dokumentacionin, kriteret dhe procedurat që duhet të zbatohen për përftimin e përjashtimit nga detyrimi për pajisje me leje pune, gjithshtu edhe lidhur me çështje të tjera të punësimit të të huajve ne vendin tonë. Janë dhënë materiale informuese për imigrantët që vijnë për punësim në Shqipëri.

- ***Informacion mbi nenet 38, 39- E drejta për t'u larguar përkohësisht, pa pasur ndikim për autorizimin e tyre të qëndrimit dhe punës, sipas rastit; e drejta e lëvizjes dhe zgjedhjes së vendbanimit në territorin e shtetit ku është punësuar. (- Articles 38, 39: Right to be temporarily absent without effect upon authorization to stay or work; right to liberty of movement and to choose the residence in the territory of the State of employment);***

54. Në lidhje me punësimin dhe qëndrimin, i huaji në Republikën e Shqipërisë ka detyrimin t'i përmbahet motivit të lëshimit të lejes së punës dhe lejes së qëndrimit, për të cilin ka imigruar. I huaji i pajisur me leje pune dhe leje qëndrimi është i detyruar të njoftojë autoritetet përgjegjëse për çdo ndryshim të kushteve, mbi të cilat është lëshuar leja e punës dhe leja e qendrimit dhe të kërkojë miratimin e saj në rast se ndryshimi lidhet me:

a) emrin dhe adresën e punëdhënësit;

b) kontratën e vlefshme të punës që mbulon kohën, për të cilën është lëshuar leja e punës;

c) aktivitetet e autorizuara si person i punësuar.

- ***Informacion mbi Nenet 49 dhe 56- autorizimi i residencës dhe autorizimi për të patur një aktivitet fitimprurës; kushtet e përgjithshme të ndalimit të dëbimit. (Articles 49 & 56: Authorization of residence and authorization to engage in a remunerated activity; general prohibition and conditions of expulsion);***

55. I huaji mund të punësohet në Republikën e Shqipërisë, duke u pajisur me leje pune, apo me certifikatë regjistrimi pune, gjithmonë në përputhje me aktivitetin fitimprurës që do të zhvillojë dhe duke u pajisur me leje qëndrimi për motiv punësimi/vetëpunësimi në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, në këtë drejtim ekzistojnë disa parashikime ligjore të cilat përcaktojnë përjashtimin nga detyrimi për t'u pajisur me leje e pune për kategoritë e shtetasve të huaj si më poshtë:

56. Shtetasit e Bashkimit Europian dhe Zonës Shengen në përputhje me parashikimet e ligjit "Për të huajt", Nr.108/2013, nuk pajisen me leje pune ose certifikate regjistrimi për të punuar në vendin tonë, ata gëzojnë te drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë në fushën e punësimit dhe vetëpunësimit. Ky parashikim ligjor vjen si rrjedhojë e përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së, si një detyrim i Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit.

57. Shtetasit e Shteteteve të Bashkuara të Amerikës nuk pajisen me leje pune ose certifikatë regjistrimi për të punuar në vendin tonë, ata gëzojnë të drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë në fushën e punësimit në përputhje me parashikimet e nenit 147 pika 2, të ligjit "Për të huajt" Nr.108/2013.
58. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare nuk pajisen me leje pune ose certifikatë regjistrimi për të punuar në vendin tonë, në përputhje me parashikimet e nenit 71 pika 1, të ligjit "Për të huajt", Nr.108/2013 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.265, datë 7.5.2014.

- ***Informacion mbi nenin 65. -Parashikimi i nxitjes së kushteve të qëndrueshme, të përshtatshme dhe humane në lidhje me migrimin ndërkombëtar të punëtorëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre. (- Article 65: Establishment of appropriate services to deal with questions concerning international migration of workers and members of their families);***

59. Në zbatim të ligjit nr. 9668, datë 18.12.2006, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi" i ndryshuar me ligjin nr.10389, datë 3.3.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9668, datë 18.12.2006, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi" dhe akteve ligjore të miratuara në zbatim të tij, vazhdon informimi falas i shtetasve shqiptarë para emigrimit dhe pas rikthimit të tyre në vend.

60. Neni 8 paragrafi 1 i Ligjit parashikon: "Autoritetet shtetërore përgjegjëse ose agjencitë private të punësimit duhet t`u sigurojnë shtetasve shqiptarë, që dëshirojnë të emigrojnë, përfshirë edhe emigrantët e rikthyer, të drejtën e informimit dhe të këshillimit falas në fushën e formimit profesional, të shërbimeve të ndërmjetësimit për punësim, të mbrojtjes sociale, të organizimit në sindikata, të mundësive për strehim, arsimim dhe sigurime shoqërore, si dhe të njohjes së kushteve të jetesës e të punës në vendin pritës, nëpërmjet mjeteve mediatike, broshurave etj."
61. Ndërsa nënpika 1 e paragrafit 1 të këtij neni parashikon: "Në zyrat përkatëse të punësimit ngrihen dhe funksionojnë sportelet e migracionit, të cilat ofrojnë shërbim informimi për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë, si dhe mbështetje për riintegrimin e emigrantëve të rikthyer."
62. Paragrafi 2 i nenit 8 parashikon se Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ndihmon në organizimin e kurseve të formimit orientues, pa pagesë, për mësimin e gjuhës ose të njohurive bazë për profesionet e kërkuara nga shteti pritës për shtetasit shqiptarë, që dëshirojnë të emigrojnë, si dhe për pjesëtarët e familjes së tyre, që do të emigrojnë apo do të ribashkohen me ta, me kusht që të jenë të regjistruar në "Regjistrin për emigrantët".
63. Në të gjithë vendin janë ngritur 36 Sportele Migracioni. Ato ndodhen në zyrat rajonale dhe vendore të punësimit dhe kanë për detyrë të informojnë shtetasit shqiptarë që duan të emigrojnë për motive punësimi dhe shtetasit shqiptarë të cilët kthehen nga emigrimi për të lehtësuar riintegrimin e tyre në vend pas kthimit.

- ***Informacion mbi nenin 66- Veprimet e autorizuara dhe institucionet për rekrutimin për punësim në një shtet tjetër. (- Article 66: Authorized operations and bodies for the recruitment of workers for employment in another State);***

64. Në vitin 2011 u miratua ligji nr.10389, datë 3.3.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9668, datë 18.12.2006 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi". Ligji përcakton ngritjen dhe funksionimin e sporteleve të migracionit, të cilat ofrojnë shërbim informimi për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë, si dhe mbështetje për riintegrimin e emigrantëve të rikthyer. Në ligj gjithashtu përcaktohen detyrimet e institucioneve për ofrimin e shërbimeve të riintegrimit shtetasve shqiptarë të kthyer në fushën e punësimit, formimit profesional, përkujdesit shoqëror, arsimit, strehimit, bujqësisë dhe transportit dhe hapjen e ndërmarrjeve të vogla apo të mesme.
65. Strukturat informuese të ngritura në nivel rajonal dhe vendor si Sportelet e Migracionit japin informacion për shtetasit shqiptarë para emigrimit të tyre dhe pas rikthimit të tyre në vend. Nëpërmjet informimit para nisjes është synuar një emigrim sa më i informuar i tyre për kushtet e vendit pritës si dhe organizatat që mbrojnë të drejtat e emigrantëve në këto vende. Informacioni dhe mbështetja për riintegrim që u jepet shtetasve shqiptarë pas rikthimit të tyre në vend synon të informojë shtetasit që kthehen për të drejtat që ata kanë pas rikthimit në vend dhe të lehtësojë marrjen e shërbimeve që lidhen me këto të drejta, si shërbime në fushën

e punësimit, arsimit, shëndetësisë, sigurimeve shoqërore, sigurimeve shëndetësore, bujqësisë etj.

- ***Informacion mbi nenin 67: Masat në lidhje me kthimin e rregullt të punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre në shtetin e origjinës, rivendosjen dhe riintegrimin kulturor. (- Article 67: Measures regarding the orderly return of migrant workers and members of their families to the State of origin, their resettlement and cultural reintegration);***[2]

IV. INFORMACION MBI CËSHTJET DHE REKOMANDIMET E PARAQITURA NGA KOMITETI I EKSPERTEVE PAS SHQYRTIMIT TE RAPORTIT TE SHQIPERISE

Rekomandimi nr 12. ***Informacione mbi legjislacionin vendas rregullues të migracionit, duke përfshirë Ligjin "Për migrimin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi", Ligjin "Për të huajt", sikurse dhe informacion konkret lidhur me zbatimin e tyre.***

66. Në vitin 2011 u miratua ligji nr.10389, datë 3.3.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9668, datë 18.12.2006 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi". Ligji përcakton ngritjen dhe funksionimin e sporteleve të migracionit, të cilat ofrojnë shërbim informimi për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë, si dhe mbështetje për riintegrimin e emigrantëve të rikthyer. Në ligj përcaktohen gjithashtu detyrimet e institucioneve për ofrimin e shërbimeve të riintegrimit shtetasve shqiptarë të kthyer në fushën e punësimit, formimit profesional, përkujdesit shoqëror, arsimit, strehimit, bujqësisë dhe transportit dhe hapjen e ndërmarrjeve të vogla apo të mesme.
67. Ndryshimet e bëra me miratimin në vitin 2011 të ligjit nr.10389, datë 3.3.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9668, datë 18.12.2006 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi" bëjnë të mundur zbatimin e detyrimeve të konventës për riintegrimin e punëtorëve migrantë shqiptarë, të cilët kthehen në vendin e tyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre.
68. Ngjarja më e rëndësishme në përmirësimin e legjislacionit shqiptar për migracionin gjatë viteve 2013-2014 ishte miratimi i ligjit "Për të Huajt" Nr. 108/2013 i miratuar në dt.28.3.2013, botuar në Fletoren Zyrtare më 5 prill 2013, i cili hyri në fuqi më 20 prill 2013.
69. Ligji "Për të Huajt" 108/2013 synon përfshirjen dhe zbatimin e angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në kuadrin e Planit Kombëtar të Përafrimit të

[2] Referim informacionit mbi rekomandimin nr. 36

Legjislacionit dhe të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Gjithashtu në këtë ligj, janë pasqyruar edhe dispozita të acquis-së së Bashkimit Evropian, në fushën e migrimit si dhe rekomandime të fundit të BE-së.

70. Ai garanton aksesin në tregun e punës për shtetasit e BE-së për t'u punësuar pa aplikuar për leje pune dhe trajtimin e tyre sikurse dhe shtetasit shqiptarë, për sa i përket punësimit, kushteve të punësimit, shpërblimit, studimit, formimit profesional, organizimit në organizatat e punëtorëve.

Në fushën e integrimit të të huajve

71. Në ligjin "Për të huajt" Nr.108/2013, është hequr neni mbi të drejtat e të huajve të punësuar në Republikën e Shqipërisë , i cili konsiderohej si një kufizim për të drejtat e të huajve që nuk përmendeshin në atë nen, meqënëse në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë shprehet qartë që të huajt në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të njëjtat të drejta sikurse edhe shtetasit shqiptarë, gjë që rrit hapësirat dhe heq kufizimet e të drejtave të shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë. Politikat e të huajve janë gjithashtu pjesë e "Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020" dhe Planit të saj të Veprimit.
72. Në vitin 2014, u punua për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.818, datë 26.11.2014. Në këtë strategji janë përfshirë edhe politika për imigracionin e punës për periudhën 2014-2020. Masat e planit të veprimit të kësaj strategjie kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në garantimin e mbrojtjes nga forma të ndryshme diskriminimi. Masat në fushën e imigracionit synojnë:

– Fuqizimin e kapaciteteve informuese dhe këshilluese për imigracionin;
– Rishikimi i legjislacionit ekzistues në lidhje me funksionimin e agjensive private të punësimit në përpudhje me standardet e ratifikuara ndërkombëtare të punës;
– Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve publike dhe private të punësimit. Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me agjensitë private të punësimit;
– Monitorimi i agjensive private të punësimit për ndërmjetësimet e kryera;
– Përmirësimin e infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve për imigrantët;
– Rritjen e bashkëpunimit me vendet e tjera për menaxhimin e emigrimit për punësim nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të punës;
– Njohjen e kualifikimeve profesionale dhe eksperiencës profesionale të fituar jashtë vendit;
– Përafrimin e vazhdueshëm të legjislacionit të imigrimit me atë të Bashkimit Evropian.

Gjatë viteve 2013-2014 pjesë e normativës migratore janë bërë:

- Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 76, 77, 69, 68, 67, 66, 85, 84, 83, 82, 81, 80, 79, 78, 74 dhe 75, date 12.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, dhe anulimin e lejes së punës" ku përfshihen respektivisht të gjithe llojet e punësimeve për shtetasit e huaj.

- Vendim i KM Nr.70, datë 12.2.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen me certifikatë regjistrimi në punë".
- Vendim i KM. Nr. 265, date 7.5.2014, "Për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune apo certifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare".
- Urdhri i Ministrit Nr.147 datë 9.7.2014 "Për deklarimin për Punësim të Shtetasve të Bashkimit Europian, zonës Shengen, Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë, të përkatësisë etnike shqiptare".

Rekomandimi nr. 16. ***Informacione me të dhëna, në përputhje me orientimet e Konventës, përfshirë të dhënat e besueshme dhe të përditësuara rregullisht dhe të kategorizuara - si një mjet për politika efektive migratore dhe për zbatimin e masave të ndryshme të Konventës.***

Informacion statistikor për të huajt, vitet 2011-2015.

73. Sipas shifrave të analizuara përgjatë viteve 2011-2015, numri i të huajve që imigrojnë drejt Shqipërisë për motive punësimi vjen në rritje. Situata e punësimit të të huajve sipas sektorëve të aktiviteteve që ushtrojnë, krahasuar me vitet paraardhës paraqitet si më poshtë:
74. **Për vitin 2011:** Janë pajisur me leje pune 2300 shtetas të huaj dhe janë përjashtuar nga detyrimi për pajisjen me Leje Pune 74 shtetas të huaj.
75. **Për vitin 2012:** Janë pajisur me leje pune 2,499 shtetas të huaj dhe janë përjashtuar nga detyrimi për pajisjen me leje pune 180 shtetas të huaj. Janë pajisur me leje për herë të parë 1,830 shtetas të huaj ose 73% e totalit.
76. **Për vitin 2013:** Janë pajisur me leje pune 2,958 shtetas të huaj (2,189 leje pune dhe 769 vërtetime punësimi) të dhëna nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Zyrat e Punësimit në varësi të tij.
77. **Për vitin 2014:** Janë pajisur me leje pune 3,443 shtetas të huaj (2,054 leje pune + 1,389 vërtetime punësimi) ose 16 % më shumë së nje vit më parë.
78. Rajoni që ka pasur fluksin më të madh të shtetasve të huaj të pajisur me leje pune është Tirana, me rreth 50% të lejeve të punës për vitet 2012 dhe 2013 dhe 41.1% për vitin 2014.

Tabela 1. Shpërndarja e lejeve të punës së lëshuarapër të huajt, sipas Zyrave të Punës

Shpërndarja e lejeve të punës	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**
DRSHKP –Tiranë	50%	48 %	50 %	41.1%
DPSHKP	16%	20%	13.7 %	13%
DRSHKP- Lezhë		1.3%	7.7 %	2.6%
DRSHKP- Fier	8%	9%	7.7 %	8.6%
DRSHKP-Shkodër	7%	2.6%	2.8%	1.41%
DRSHKP-Durrës		5.1%	5.7%	4.4%
DRSHKP Elbasan		3.3%	6.9%	14%
Total	**2300**	**2499**	**2189**	**2054**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e SHKP, Tiranë, 2015

79. Sipas burimeve nga MMSR, vendin e parë e zënë kërkesat për leje pune për kategorinë e punëmarrësve, (1938 në vitin 2011, 1,802 në vitin 2012, 1,888 për vitin 2013 dhe 1,792 për vitin 2014. Në vend të dytë janë kërkesat e të vetëpunësuarve (161 në 2011, 258 në 2012, 234 në vitin 2013 dhe 177 në vitin 2014). Në vend të tretë janë kërkesat nga investitorët.
80. Sektori më i kërkuar për punësimin e të huajve është ndërtimi (10% në 2011, 19% në 2012, 25% në 2013 dhe 31% në 2014), i ndjekur nga shërbimet (11% në vitin 2011, 7% në vitin 2012, 13% më 2013 dhe 17 % në vitin 2014), industria nxjerrëse (12% në vitin 2011, 12% në vitin 2012, 10% më 2013 dhe 14% në vitin 2014) dhe tregtia (16% në vitin, 15% në vitin 2012, 12% më 2013 dhe 9% në vitin 2014).
81. Sipas shtetësisë, vendin e parë e zënë shtetasit nga vendet jo anëtare të BE-së: turqit (25% në 2011, 19% në 2012, 39.5% në 2013 dhe 52% në 2014), pasuar nga kinezët (11% në 2011, 7.5% në 2012, 5% në 2013 dhe 12% në 2014) dhe kanadezët (7.5% në 2011, 8% në 2012, 7% në 2013 dhe 8 % në 2014).

Tabela 2. Lëshimi i lejeve të punës, kategorizuar sipas shteteve

	2011		2012		2013		2014	
	LP	%	LP	%	LP	%	LP	%
Turqi	593	26	474	19	865	39.5	1068	52
Kinë	273	12	188	7.5	112	5	248	12
Kanada	-		195	8	156	7.1	162	7.8
India	-		17	0.6	37	1.7	54	2.6
Serbia	-		11	0.4	15	0.6	37	1.8
Egjipti	-		26	1	47	2.1	32	1.5
Total	**2300**		**2499**		**2189**		**2054**	

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e SHKP, Tiranë, 2015

82. Të huajt e pajisur me Leje Pune ishin më së shumti meshkuj (86.2% në 2012, 88.5% në 2013 dhe 92 % në 2014.

Grafik: Numri i shtetasve të gjinisë femërore të pajisura me leje pune, në vite;



Burimi: *Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë*

PS: *Në tabelë nuk është vendosur numri i vërtetimeve të deklarimit, lëshuar shtetaseve të BE, Zonës Shengen, U.S.A dhe Shtetasve të Republikës së Kosovës dhe shtetasve të Republikës së Serbisë, të përkatësisë etnike shqiptare, të cilët që nga vitet 2013-14 nuk pajisen me leje pune për të punuar në Shqipëri.*

83. Gjatë viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014 janë përjashtur nga detyrimi për tu pajisur me leje pune respektivisht 74, 180, 199 dhe 194 persona. Pjesa më e madhe e ketyre perjashtimeve janë në Tiranë (89% në 2011, 58% në vitet 2012 dhe 2013, 64% në vitin 2014), në Elbasan (respektivisht 24% në 2012, 1.5% në 2013 dhe 11% në 2014) dhe Shkodër (2.7% (2012), 24% (2013), 6% (2014).
84. Sipas shtetësisë, shumica e përjashtimeve janë bërë për shtetas turq (0.5% në 2012, 18% në 2013, 22% në 2014), koreano-jugorë (3% në 2013 dhe 14.,4% në 2014), kinezë (respektivisht 14%, 9%, 12%), braziliane (respektivisht 4.5% në 2013 dhe 10% në 2013), indianë (respektivisht 3%, 7%, 8% dhe kanadezë (respektivisht 0.5% në 2012 dhe 5.6% në 2014). Shumica e të përjashtuarve nga ky detyrim janë misionarë fetarë, profesionistë dhe punonjës vullnetarë. Në vitin 2014 ata zinin respektivisht 60.3%, 14% dhe 10.3% të përjashtimeve. Të punësuarit e huaj informalë përbënin 10% të të huajve në 2012, 4% në 2013 dhe 1% në 2014.

Informacion statistikor për vitin 2015

85. Nisur nga mbledhja dhe analizimi i të dhënave statistikore, për 9-mujorin e vitit 2015, Drejtoritë Rajonale që kanë numrin më të madh të kërkesave për pajisjen me leje pune dhe me vërtetime deklarimi për punësim janë :

Leje pune të dhëna sipas sektorit të aktivitetit;

Grafik 3: Sektorët më të preferuar , nëse do të marrim për bazë zhvillimin e aktivitetit ekonomik;



Burimi : Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit

Vërtetime Deklarimi për Punësim sipas sektorit të aktivitetit;

Grafik 4: Sektorët më të preferuar , nëse do të marrim për bazë zhvillimin e aktivitetit ekonomik;



Burimi : Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit

Kategorizimi sipas shtetësisë;

Sipas tabelës së mëposhtme numri i shtetasve të huaj, të pajisur me leje pune dhe të punësuar pranë subjekteve të ndryshme me aktivitet në Shqipëri, është si më poshtë:

Grafik 5: Leje pune të lëshuara sipas shtetësisë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit

Numri i shtetasve të huaj, të pajisur me një vërtetim deklarimi për punësim, është si më poshtë:

Grafik 6: Vërtetime deklarimi të lëshuara sipas shtetësisë;



Burimi : Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit

Leje Pune të ndara sipas tipit;

Sipas tipit të lejes së punës, vazhdon të dominojë *kategoria e punëmarrësve, me 82%* të lejeve të punës.

Grafik 7: Leje Pune të ndara sipas tipit të lejes;



Burimi : Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit

Sipas gjinisë;

- Leje pune të dhëna për herë të parë 860. Nga 1282 leje pune të dhëna gjithsej për këtë periudhë 121 ose 9 % e tyre janë dhënë për shtetase të huaja femra.

Grafik 8: Leje pune të lëshuara sipas gjinisë;



Burimi : Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit

- Nga 1083 Vërtetime Deklarimi për punësimim të dhëna për këtë periudhë 208 janë dhënë për shtetase të huaja femra, 820 i përkasin kategorisë së punëmarrësve, 254 të vetëpunësuarve dhe 9 vërtetime të dhëna për investitorë.

Grafik 9: Vërtetime Deklarimi të lëshuara sipas gjinisë;



Burimi : Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit

Analizë cilësore e lejeve të punës dhe vërtetimeve të deklarimit;

86. Nga të dhënat e pasqyruara, në lidhje me lejet e punës të lëshuara për këtë 9-mujor, vihet re një rënie me 5% e numrit total të tyre, në krahasim me 9-mujorin e vitit 2014.
87. Përsa i përket shtetësisë, vazhdojnë të mbizotërojnë shtetasit turq, me 703 leje pune, ose 55% e totalit. Shtetasit turq kanë patur një rritje me 87 leje pune më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
88. Nëse do të marrim për bazë zhvillimin e aktivitetit ekonomik, sektori më i preferuar për këtë periudhë është ai i ndërtimit, me 465 leje pune ose 36% e totalit, nga 20% e totalit që ishte në 9-mujorin e vitit të kaluar.
89. Përsa i përket vërtetimeve të punësimit, nuk vihet re ndonjë ndryshim i ndjeshëm krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, shtetasit italianë vazhdojnë të jenë kategoria më e madhe e pajisur me këtë dokument, me rreth 50% të totalit, ndjekur nga ata kosovarë me 16%.
90. Nëse do të marrim për bazë zhvillimin e aktivitetit ekonomik, sektori më i preferuar për këtë periudhë është tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve , me 208 vërtetime ose 19 % e totalit, në ndryshim nga 9-mujori i vitit 2014, kur ishte industria përpunuese me 112 vërtetime, ose 12% e totalit.
91. Informacion mbi përjashtimet nga detyrimi për pajisje me leje pune për periudhën *Janar – Shtator 2015;* Referuar dokumentacionit që posedohet, rezulton se; gjatë periudhës Janar-Shtator 2015, janë pajisur gjithsej 186 shtetas të huaj me Certifikatën e regjistrimit në punë, si më poshtë:

Grafik 1: Kategoria e përfituesve të Certifikatës së regjistrimit në punë sipas gjinisë;



Burimi : Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore

Grafik 2: Kategoria e përfituesve të Certifikatës së regjistrimit në punë *sipas vendbanimit;*



Burimi : Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore

Nga *186* persona gjithsej, *80 prej tyre, ose 43% e totalit,* janë me banim në Tiranë.

Grafik 3: Kategoria e përfituesve të Certifikatës së regjistrimit në punë *sipas statusit professional;*



Burimi : Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore

Sikurse vihet re, dominojnë ata me statusin e vullnetarit fetar, *72 persona ose 38% e totalit.*

Grafik 4: Kategoria e përfituesve të Certifikatës së regjistrimit në punë sipas shtetësisë;



Burimi : Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore

92. Nga të dhënat, vihet re se numrin më të madh, e zënë shtetasit turq me *88 persona , ose 47% e totalit*, të ndjekur nga ata me shtetësi koreane dhe kineze, me nga 15 dhe 11 persona përkatësisht.
93. Tirana vazhdon të jetë qyteti me përqëndrimin më të madh të kësaj kategorie, me *88 shtetas*, kurse përsa i përket profesionit, *72 persona*, janë vullnetarë fetarë.

94. Gjatë periudhës Janar – Shtator 2015, janë pajisur me *Vërtetim deklarimi për punësim, 151 shtetas të huaj*, në përputhje me nenet 71 pika 1, 72 "a" dhe 147 pika 2 të Ligjit "Për të huajt", Nr. 108/2013, si dhe VKM-në Nr.265, datë 7.5.2014.

Grafik 5: Kategoria e përfituesve të vërtetimit të deklarimit për punësim *sipas gjinisë;*



Burimi : Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore

Grafik 6: Kategoritë e përfituesve të vërtetim deklarimi për punësim *sipas shtetësisë;*



Burimi : Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore

Grafik 7: Kategoria e përfituesve të Vërtetimeve të deklarimit në punë *sipas statusit profesional;*



Burimi : Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore

Grafik 8: Kategoritë e përfituesve të vërtetim deklarimi për punësim *sipas vendbanimit;*



Burimi : Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore

95. Nga të dhënat vihet re se mbizotërojnë shtetasit italianë me 41 persona, ose 27% e totalit. Në vendin e dytë janë shtetasit amerikanë, me 33 persona, ose 21% e numrit total. Shtetasit amerikanë kanë pësuar një rritje të ndjeshme, me rreth 45% më shumë vërtetime deklarimi, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014.
96. Tirana është qyteti me përqëndrimin më të madh të kësaj kategorie. 67 shtetas ose 44% e totalit. Përsa i përket profesionit, vendin e parë e zënë vullnetarët fetarë, me 97 persona ose 64% e totalit, në vendin e dytë, me 24 persona ose 15% e totalit, janë ata me profesion mësues.

Lëvizjet migratore të shqiptarëve

97. Për sa i përket imigrimit të shqiptarëve, në periudhën kohore 2011 – 2015, emigracioni shqiptar është karakterizuar edhe nga kthimi i emigrantëve shqiptarë në vendin e tyre të origjinës. Sportelet e Migracionit (SM) janë struktura të ngritura për t'u ardhur në ndihmë shtetasve shqiptarë të kthyer për lehtësimin e riintegrimit të tyre në vend pas kthimit.
98. Në të gjithë vendin janë ngritur 36 Sportele Migracioni. Në zbatim të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010 - 2015 dhe Planit të saj të veprimit këto struktura intervistojnë shtetasit shqiptarë të kthyer që paraqiten në sportel, japin informacion për shërbimet publike dhe ato private, në përputhje me nevojat e identifikuara (kur ekzistojnë) dhe bëjnë referim tek shërbimet publike dhe ato private (kur ekzistojnë) si dhe projekte specifike të shoqërisë civile në përputhje me nevojat e shtetasve shqiptarë të kthyer. Shtetasit shqiptarë të kthyer paraqiten vullnetarisht pranë këtyre sporteleve.
99. Nga janari i viti 2011 deri në qershor të vitit 2015 janë paraqitur pranë Sporteleve të Migracionit 4673 shtetas shqiptarë të kthyer. Që prej vitit 2012 deri në vitin 2015 ka një ulje të numrit të shtetasve shqiptarë që janë paraqitur në SM. Femrat përbëjnë gjysmën e shtetasve shqiptarë të kthyer të paraqitur pranë sporteleve të migracionit.

Tabela 1. Shtetas shqiptarë të kthyer të regjistruar në Sportelet e Migracionit (SM) sipas viteve;

VITI	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Janar - qershor 2015
Shtetas shqiptarë	**896**	**1536**	**1171**	**834**	**236**

Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

100. Numri më i madh i kthimeve është kthim afatgjatë dhe familjar. Ky grup shtetasish shfaq një nevojë më të madhe për mbështetje për riintegrim. Duke qënë se kanë menduar të kenë një kthim afatgjatë dhe duke u kthyer familjarisht nevojat e tyre për riintegrim kanë qënë më të mëdha duke bërë që t'i drejtohen SM për të marrë shërbime. Një pjesë e vogël shtetasish të kthyer është shprehur se kanë bërë kthim të përkohshëm dhe individual. Kjo e fundit mund të

lidhet me pavendosmërinë e tyre për të qëndruar në Shqipëri pas kthimit, pasi paraqitja në sportele tregon se kanë patur nevojë për shërbime për riintegrimin e tyre.

101. Dy vendet kryesore nga janë kthyer shtetasit shqiptarë janë Greqia dhe Italia. Kjo përkon edhe me emigrimin e shtetasve shqiptarë i cili është më së shumti i përqëndruar në këto dy vende. Pjesa më e madhe e shtetasve shqiptarë të kthyer të paraqitur pranë SM janë kthyer nga Greqia duke përbërë afërsisht 80 % të gjithë të regjistruarve të kthyer të regjistruar në sportelet e migracionit. Shumë më pak janë shtetasit që janë kthyer nga Italia me rreth 14% të të kthyerve të regjistruar në sportele. Të kthyerit nga vende të tjera të BE dhe joanëtare të BE të paraqitur në SM zënë një vend shumë të vogël.

Tabela 2. Shtetas shqiptarë të paraqitur në SM sipas shtetit nga janë kthyer për vitin 2012, 2013, 2014, 2015

VITI	Viti 2012		Viti 2013		Viti 2014		Janar - qershor 2015	
SHTETI		%		%		%		%
Greqia	1321	86	963	82 %	679	81	166	70 %
Italia	188	12.2	131	11 %	121	14	59	25 %
Vende të tjera të BE	17	1.1	64	5.4 %	21	2.5	8	3 %
Vende jo anëtare të BE	10	1	13	1 %	12	2	3	1.2 %

Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

102. Shumica e kthimeve ka ndodhur për shkak të papunësisë në vendin pritës. Vihet re se nga viti 2012 deri në vitin 2015 ka ardhur duke u rritur numri i të kthyerve që kthehen për motive të tjera ndër të cilat edhe investimet, megjithatë ai mbetet ende i vogël. Një arsye për numrin e vogël të tyre mund të jetë edhe mosparaqitja e këtij grupi në sportele për shkak se vijnë me një plan të mirëmenduar dhe punojnë për ta vënë në zbatim. Pjesa që paraqitet në SM mund te jetë ajo pjesë e cila ende nuk e ka të konsoliduar mire ose i mungojnë fondet e mjaftueshme për të investuar dhe hapur biznesin e tyre ose kanë nevojë për më shumë informacion në këtë drejtim.
103. Në përgjithësi, shkaqet që i kanë shtyrë shtetasit shqiptarë të kthehen përgjatë viteve 2012, 2013, 2014 nuk kanë patur ndryshime të mëdha. Megjithatë në vitin 2014 vihet re një tendencë në ulje e kthimeve për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe një rritje e kthimeve për shkaqe të tjera (jo papunësisë).

Tabela 3. Shtetas shqiptarë të kthyer të regjistruar në SM sipas shkakut të kthimit për vitet 2012, 2013, 2014, 2015

VITI	Viti 2012		Viti 2013		Viti 2014		Janar - qershor 2015	
SHKAKU KTHIMIT		%		%		%		%
Papunësia	1348	88 %	1060	91 %	736	88 %	206	87 %
Mungesa e dokumentacionit	31	2 %	67	5.1 %	43	5 %	15	6.3 %
Për të investuar	9	1 %						
Shkaqe të tjera			43	3.7 %	55	6.5 %	15	6.3 %

Burimi: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

104. Pjesa më e madhe e shtetasve shqiptarë të kthyer të paraqitur në sportelet e migracionit i përkasin grupmoshave 25 vjec deri në 34 vjec, 35 vjec deri në 44 vjec dhe 45 vjec e më shumë. Nuk ka ndryshim të madh në vite përsa i përket grupmoshave të shtetasve shqiptarë të kthyer të cilët janë paraqitur në sportele.
105. Shumica e shtetasve shqiptarë të kthyer të cilët janë drejtuar në Sportelet e Migracionit për të marrë shërbime riintegrimi janë në pjesën më të madhe me arsim 9-vjeçar dhe të mesëm.

Rekomandimi nr. 20. ***Informacione për mosdiskriminim e të gjithë punëtorëve migrantë dhe familjarëve të tyre si dhe fushata informuese.***

106. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 4.02.2010, miratoi Ligjin nr. 10221 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Ky ligj ka për qëllim të nxisë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit si dhe të sigurojë mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminim.
107. Lidhur me objektin e Ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", në nenin 1 të tij parashikohet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.
108. Bazuar në Ligjin nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" me diskriminim do kuptojmë "çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".

109. Si forma të diskriminimit, ligji parashikon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, diskriminim për shkak të shoqërimit, shqetësim, udhëzim për të diskriminuar, mohimin e një përshtatjeje të arsyeshme dhe viktimizimin.
110. Në ligjin "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" vendoset ndalimi i diskriminimit në ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, sipas të cilit "ndalohet diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t'u zgjedhur dhe për t'u emëruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji" (neni 9); si dhe ndalimi i diskriminimit lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, sipas të cilit "ndalohet diskriminimi lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, veçanërisht kur ka të bëjë me shprehjen e tyre individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve" (neni 10).

Rekomandimi nr. 28. ***Informacione rreth nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe në fushën e sigurimeve shoqërore, kuadrin ligjor dhe politikat për migrimin, përfshirë përgjegjësitë përkatëse të subjekteve të ndryshme të qeverisjes dhe përbërjen e sistemit të menaxhimit shtetërore të punësimit jashtë vendit.***

111. Në prill të vitit 2014 u nënshkrua me shtetin e Katarit "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit në lidhje me Rregulloren e punësimit të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë në Shtetin e Katarit". Marrëveshja rregullon dhe lehtëson procedurën e rekrutimit të fuqisë punëtore shqiptare në Shtetin e Katarit. Ajo vendos një bashkëpunim më të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit dhe Ministrisë së Mirëqenies dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja lehtëson qasjen kërkesë – ofertë ndërmjet punëdhënësve në Shtetin e Katarit dhe shtetasve shqiptarë të cilët dëshirojnë të punësohen në Shtetin e Katarit, nëpërmjet përfshirjes së institucioneve shtetërore në proçesin e rekrutimit. Ajo krijon mundësinë e rekrutimeve nëpërmjet kanaleve shtetërore duke forcuar mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë që punësohen në Shtetin e Katarit.
112. Është në proces hartimi dhe negociimi teksti i Projekt-marrëveshjes ndërmjet Konfederatës Zvicerane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shkëmbimin e profesionistëve të rinj. Objekti i projekt-marrëveshjes është punësimi për një kohë të kufizuar i shtetasve shqiptarë, profesionistë të rinj në Zvicër me qëllim rritjen më tej të njohurive të tyre profesionale dhe gjuhësore dhe anasjelltas.
113. Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2014 është punuar për vazhdimin e zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale të Republikës Italiane dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për Migracionin e Punës, nënshkruar në Korrik të vitit 2011. Zbatimi i Memorandumit filloi në Nëntor të vitit 2011 deri në fund të vitit 2013. Në saj të projekteve që mbështetën zbatimin e tij u bë e mundur që të fitojnë të

drejtën e preferencës për të hyrë në tregun italian të punës rreth 700 kandidatë, shumë prej të cilëve siguruan leje pune dhe mundësine të punojnë në shtetin italian.

Vendosja e bashkëpunimit me agjencitë private të punësimit.

114. Nënshkrimi në 28 prill 2015 i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Europe Agency, Prill 2015 – Dhjetor 2016. 87. Qëllimi i Memorandumit është angazhimi i Paleve për publikimin dhe rekrutimin e punëkërkuesve shqiptarë për pozicione të ndryshme pune jashtë shtetit.

Marrëveshje me shtetet e tjera në kuadër skemave shoqërore të mbrojtjes së punëtorëve

115. Shqipëria ka nënshkruar disa marrëveshje me shtete të tjera. Konkretisht si më poshtë vijon paraqitet ecuria e marrëveshjeve për mbrojtjen shoqërore:
116. Aktualisht është në zbatim Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për mbrojtjen shoqërore", e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2005 dhe po zbatohet nga dy institucionet kompetente qe jane Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshem te Kujdesit Shëndetsor.
117. Bashkëpunimi me Belgjikën ka nisur në mars 2010, me negociatat e para dhe ka përfunduar me miratimin e ligjit nr.35/2014, date 3.4.2014. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në Janar 2016 dhe priten të përfitojne rreth 35 mijë shtetas shqiptarë dhe shtetas belg që jetojnë e punojnë në RSH.
118. Bashkëpunimi me Maqedoninë për Marrëveshjen për Mbrojtjen Shoqërore ka filluar ne vitin 2011. Marrëveshja është miratuar në Këshillin e Ministrave me VKM nr 228. dt 11.03.2015 dhe u nënshkrua në Shkup në 17 Mars, 2015, nga ministrat homologë të çështjeve sociale. Janë rreth 1500 shtetas shqiptarë dhe rreth 300 shtetas maqedonas të cilet do të perfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në të dy vendet. Aktualisht Marrëveshja po i nështrohet procedurave të ratifikimit në Kuvend.
119. Bashkëpunimi me Hungarinë ka nisur në vitin 2011. Ndonëse numri i qytetarëve shqiptarë në Hungari dhe atyre hungarez në Shqipëri nuk është i ndjeshëm, marrëveshja është e rëndësishme sepse mbrohen emigrantët edhe në vendet e tjera me të cilët kemi marrëveshje dy palëshe. Marrëveshja është miratuar me VKM nr.531, date 6.8.2014 dhe është nënshkruar në Tiranë në datë 10.12.2014. Aktualisht po i nënshtrohet procedurave të ratifikimit.
120. Negociatat per hartimin e marrëveshjes dypalëshe me Rumaninë për mbrojtjen shoqërore kanë nisur në vitin 2012, edhe si rezultat i shfuqizimit të marrëveshjes ekzistuese të vitit 1956, e cila ishte e pazbatueshme në kushtet e reja ekonomike e sociale te vendit. Numri i përfituesve është i ulet por gjithsesi i vjen në mbrojtje per perfitimin e pensionit dhe perfitimeve te tjera shendetsore gjatë kohes qe shtetasit shqiptaret jetojne e punojne ne Rumani dhe anasjelltas. Nënshkrimi i "Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë" u realizua në Bukuresht, në 27 shkurt 2015

ndërmjet Ministrave homologë të çështjeve sociale. Aktualisht kanë filluar procedurat per dergimin e praktikes se marreveshjes për ratifikim, ne Kuvendin e Shqiperise, përmes MPJ.

121. Marrëveshja me Kanadanë ka filluar në Tetor 2013 dhe është miratuar në Këshillin e Ministrave me VKM Nr 336. Dt 22.04. Janë rreth 29 mijë shqiptarë që kanë emigruar në Kanada pas viteve 90 qe kane histori pune ne Shqiperi dhe ne Kanada dhe pas disa vitesh do te perfitojne pension duke bashkuar periudhat e sigurimit ne te dy vendet. Vlen te theksohet se nga marreveshja perfitojne edhe shume punonjes kanadeze te cilet punojne si te derguar ne Shqiperi nga kompanite e tyre me seli në Kanada. Pritet t'i nështrohet procedurave të nënshkrimit dhe më pas procedurave të ratifikimit në Kuvend.
122. Marrëveshja me Dukatin e Madh të Luksemburgut ka filluar në vitin 2012 dhe kanë vazhduar me procedurat e negociimit deri në nëshkrimin e saj. Në 27 tetor 2014 u realizua nënshkrimi nga ministrat e dy vendeve. Marrëveshja u ratifikua në Kuvend, me ligjin nr.42/2015, date 16.04.2015. Kanë vijuar negociatat për finalizimin e rregullores administrative dhe formularëve teknikë të zbatimit gjatë periudhës 2014-2015. Në këtë marrëveshje nuk janë pranuar përfitimet për kujdesin shëndtësor vetëm në rastet kur personi është i siguruar në menyrë vullnetare. Në bashkëpunim me MPJ dhe institucionet zbatuese po vazhdohet me procedurat e zbatimit të marrëveshjes.
123. Në lidhje me Marrëveshjen për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, në Janar 2015 u zhvillua në Tiranë, raundi i parë i negociatave për marrëveshjen dypalëshe të mbrojtjes shoqërore ndërmjet RSH dhe Gjermanisë, ku u diskutua projekti i Marrëveshjes dhe Protokollit, të propozuara nga pala gjermane. Raundi i radhës i negociatave u zhvillua në Berlin, Gjermani në Prill 2015 ku të dy palët ranë dakort mbi tekstin e Marrëveshjes dhe Protokollit përfundimtar që i bashkëlidhet kësaj Marrëveshje. Marrëveshja është përkthyer zyrtarisht dhe më tej i është nënshtruar procesit të dhënies dhe reflektimit të mendimeve në Ministritë e Linjës. Është miratuar në Këshillin e Ministrave me VKM nr 727, dt 02.09.2015 dhe është nënshkruar në 23 Shtator 2015 në Tiranë. Aktualisht po përgatiten të gjitha procedurat e nevojshme për ratifikimin e saj. Zbatimi i saj do te jete me shume interes per shqiptaret e emigruar ne Gjermani te cilet jane rreth 14 mije e 300 persona si dhe për shtetasit gjerman që vijnë për të punuar në RSH.
124. Negociatat për Marrëveshjen me Çekinë kanë filluar në vitin 2012 për Marrëveshjen e Mbrojtjes Shoqërore. Në raundin e fundit të negociatave, të zhvilluara në Çeki u konkludua dhe parafinua marrëveshja për mbrojtjen shoqërore. Gjatë këtij raundi u miratuan nga të dy palët marrëveshja bazë për mbrojtjen shoqërore, si dhe marrëveshja administrative. Marrëveshja është përkthyer zyrtarisht dhe më tej i është nënshtruar procesit të dhënies dhe reflektimit të mendimeve në Ministritë e Linjës. Është miratuar në Këshillin e Ministrave me VKM nr 728, dt 02.09.2015 dhe është nënshkruar në 13 Tetor 2015 në Pragë. Aktualisht po përgatiten të gjitha procedurat e nevojshme për ratifikimin e saj.
125. Në datat 2-5 Qershor 2015 u zhvilluan në Tiranë negociatat për Marrëveshjen për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, të cilat u

përqëndruan në diskutimin e plotë nen për nen të Draftmarrëveshjes, tekst i cili u propozua nga pala Austriake. Gjatë diskutimit të tekstit u bënë ndryshime në nene të veçanta, të cilat konsistojnë në përmirësimin e disa dispozitave që kanë të bëjnë me çështjet e sigurimeve shoqërore si dhe saktësime gjuhësore. Si rezultat i bisedimeve u ra dakort mbi një draft-marrëveshje për mbrojtjen shoqërore. Raundi i radhës së negociatave u zhvillua në Vjenë gjatë periudhës 9 – 13 nëntor 2015 ku palët parafinuan tekstin e marrëveshjes bazë, si dhe ranë dakort për draftin e marrëveshjes administrative.

126. Aktualisht është në proces miratimi i vendimit të Këshillit të Stabilizim Asocimit për koordinimin e skemave të sigurimeve hoqerore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE, në zbatim te nenit 48 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Fillimi i negociatave për koordinimin e skemave të mbrojtjes shoqërore me vende të tjera

127. MMSR ka shprehur interesin dhe po punon për të shtuar numrin e marrëveshjeve dypalëshe për mbrojtjen shoqërore, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe misionet diplomatike, kryesisht në Itali dhe Greqi, ku jetojnë një numër i lartë emigrantësh shqiptarë. Me Italinë ka filluar bashkëpunimi ne nivelin teknik për te analizuar dhe vlerësuar sistemet e sigurimeve shoqërore ne dy vendet respektive, për te vazhduar me pas me negociatat për marrëveshje dypalëshe.

128. Ka filluar bashkepunimi me qeverine e Kosoves per te patur nje marreveshje te mbrojtjes shoqerore ndermjet dy vendeve ne mbrojtje te shtetasve te dy vendeve me elemente te sigurimeve shoqerore e shendetsore. Janë shkembyer informacionet ne lidhje me funsksionimin e skemave te mbrojtjes shoqerore ne te dy vendet, per te vazhduar me negociatat per diskutimin e draft marrëveshjes bazë.

129. Ka filluar bashkëpunimi edhe me Qeverinë Spanjolle, Kroacinë, Danimarkën, Francën, te cilat kane shprehur interesin për të nisur negociatat për marrëveshje dypalëshe, propozim ky që është pritur pozitivisht nga Qeveria shqiptare dhe konkretisht kane filluar shkëmbimet e informacioneve te ndërsjellta për sistemet e mbrojtjes shoqërore. MMSR është e interesuar që të nisë bashkëpunimin edhe me Bullgarinë pasi janë vërejtur mjaft probleme te cilat do te gjejnë zgjidhje me hartimin e një marrëveshje te re te mbrojtjes shoqërore ndërmjet dy vendeve. MMSR po punon që të lidhë marrëveshje edhe me të tjera Shtete Anëtare të BE-së dhe vende evropiane jashtë BE-së, siç është Zvicra.

Rekomandimi nr. 34. ***Informacione mbi prezantimin dhe raportimin e situatës së punëtorëve sezonalë***[3].

[3] Referim përgjigjes mbi rekomandimin nr. 12 si më lart.

Rekomandimi nr. 36. ***Informacione rreth marrëveshjeve të nënshkruara nga Shqipëria dhe vendet pritëse të përfshijnë garanci procedurale të përshtatshme për migrantë, të cilat lehtësojnë kthimin vullnetar të punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, sikurse dhe riintegrimin e qëndrueshëm të tyre shoqëror dhe kulturor.***

Për riintegrimin e shtetasve shqiptarë që kthehen janë marrë këto masa:

130. Përmirësimi i bazës ligjore ekzistuese në lidhje me mbështetjen për riintegrim. Në periudhën 2011 – 2015, janë miratuar dy ligje të reja që ndryshojnë legjislacionin ekzistues, shtatë Vendime të Këshillit të Ministrave, tre Urdhra të Ministrit dhe gjashtë Udhëzime të Ministrit. Ndryshimet ligjore janë në në fushën e kthimit dhe riintegrimit, punësimit, formimit profesional, arsimit, strehimit dhe bujqësisë dhe reflektojnë detyrimet e institucioneve shtetërore për të lehtësuar riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer.
131. Krijimi dhe përmirësimi i kuadrit institucional për mbështetjen e riintegrimit të shtetasve shqiptarë të kthyer. Janë ngritur në të gjithë vendin, në Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit, 36 Sportele Migracioni. Sportelet e Migracionit bëjnë intervistimin, informimin dhe referimin e shtetasve shqiptarë të kthyer sipas problematikës që ata kanë në institucionet përkatëse. Gjatë periudhës korrik 2010 – qershor 2015 janë regjistruar dhe kanë marrë shërbime riintegrimi (intervistim, informim dhe referim) në Sportelet e Migracionit në të gjithë vendin gjithsej 5217 shtetas shqiptarë të kthyer.
132. Rritja e kapaciteteve të strukturave që merren me riintegrimin e të kthyerve në Shqipëri. Punonjësit e Sporteleve të Migracionit janë trajnuar çdo vit për rritjen e njohurive të tyre për intervistimin, identifikimin e nevojave, dhënien e informacionit dhe referimit shtetasve shqiptarë të kthyer. Shtetasit shqiptarë që kthehen në kufi kanë patur në dispozicion shërbimin e transportit nga Pikat e Kalimit Kufitar deri në qendrat me të afërta urbane si edhe për grupet vulnerabël deri në qendrat më të afërta të banimit.
133. Mbështetja e riintegrimit ekonomik të shtetasve shqiptarë të kthyer në Shqipëri përmes informacionit. Janë përgatitur dhe botuar fletëpalosje me informacion orientues për të kthyerit për shërbimet e riintegrimit që ofrojnë Sportelet e Migracionit për t'u shpërndarë tek shtetasit shqiptarë të kthyer në Pikat e Kalimit Kufitar.
134. Mbështetja e riintegrimit ekonomik të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes programeve të nxitjes së punësimit. Emigrantët e kthyer me probleme ekonomike, që plotësojnë kriteret e përcaktuara, janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit.
135. Mbështetja e riintegrimit ekonomik të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes përfshirjes në kurset publike të formimit profesional. Shtetasit shqiptarë të kthyer të paraqitur pranë Sporteleve të Migracionit të cilët kanë shprehur nevojën për formim profesional janë orientuar në strukturat përkatëse.

136. Mbështetja e riintegrimit të shtetasve shqiptarë të kthyer në Shqipëri në sistemin shëndetësor, të sigurimeve shëndetësore dhe mbrojtjes sociale. Punonjësit socialë në Drejtoritë e Shëndetit Publik kanë bërë informimin dhe orientimin e shtetasve shqiptarë të kthyer sipas nevojave të paraqitura. Në Drejtoritë e Shëndetit Publik është ngritur Shërbimi Psikosocial dhe ai i Shëndetit Mendor me shërbimet e të cilit trajtohen dhe shtetasit shqiptarë të kthyer, sipas nevojave që ata paraqesi.
137. Mbështetja e riintegrimit të shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat rurale përmes programeve për nxitjen e investimeve në bujqësi. Në programet për nxitjen e investimeve në sektorin e bujqësisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit janë përfshirë dhe shtetasit shqiptarë të kthyer
138. Mbështetja e riintegrimit të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes bashkëpunimit me shoqërinë civile. Sportelet e Migracioni kanë punuar për krijimin e një database-i për organizatat lokale dhe ndërkombëtare, në qarkun përkatës që ofrojnë shërbime për shtetasit shqiptarë të kthyer
139. Në korrik 2011 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit në lidhje me zbatimin e marrëveshjes për migracionin e punës me Italinë. Zbatimi i Memorandumit ka filluar në Nëntor të 2011 dhe vazhdon të zbatohet. Gjatë kësaj kohe janë regjistruar në total 5329 kandidatë dhe kanë fituar të drejtën e preferencës për të hyrë në tregun italian të punës 700 kandidatë.
140. Në Maj të vitit 2012 u nënshkrua me palën gjermane Memorandumi i Mirëkuptimit në kuadër të bashkëpunimit në projektin pilot "Triple Win Migration". MoU synonte riaktivizimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Punësimin e Punëtorëve për Zgjerimin e Njohurive të tyre Profesionale dhe Gjuhësore për disa profesione të kërkuara nga tregu gjerman i punës të nënshkruar në vitin 1991.
141. Në kuadër të këtij MoU parashikohej dërgimi në Gjermani deri në 20 infermierë. Për të ardhmen i është bërë kërkesë palës gjermane për mundësinë e riaktivizimit të marrëveshjes së 1991 –it edhe për profesione të tjerë për sektorët e punësimit dhe profesione për të cilat tregu Gjerman i punës ka nevojë për fuqi punëtorë të huaj.

Rekomandimi nr. 38. ***Informacione rreth masave të ndrëmarra për fëmijët e punëtorëve migrantë***

142. Lidhur me nxënësit, të cilët rikthehen nga emigrimi dhe kërkojnë të regjistrohen në institucionet arsimore parauniversitare, njësitë arsimore vendore (DAR/ZA), kanë marrë masat për:
143. Pranimin dhe administrimin e kërkesave të prindërve dhe/ose kujdestarëve të nxënësve dhe të dokumentacionit shkollor që ata disponojnë për regjistrimin e nxënësve në institucionet arsimore te sistemit parauniversitar.
144. Ngritjen e komisionit të pranimit të nxënësve që kthehen nga emigracioni. Komisioni mbështetur në vet deklarimin e prindërve dhe në dokumentacionin shkollor që disponojnë vetë

nxënësit, vlerësojnë dhe caktojnë klasën ku nxënësit i përket të regjistrohet. MAS më pas njoftohet zyrtarisht nga DAR/ZA lidhur me vendimin e komisionit të pranimit për procesin e regjistrimit të nxënësve refugjatë.

145. Hartimin e evidencës për pranimin e nxënësve të kthyer nga emigracioni.
146. Caktimin e institucionit arsimor, ku do të regjistrohet nxënësi, duke u mbështetur në vendimin e Komisionit te pranimit dhe në bashkëpunim me prindërit dhe/ose kujdestarin e nxënësit.
147. Hartimin e një plani të posaçëm pune nga njësia e shërbimit psiko-social në DAR/ZA për ofrimin e shërbimeve që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve që kthehen nga emigracioni.
148. Institucionet arsimore të mundësojnë pajisjen e nxënësve të regjistruar me tekstet shkollore.

149. Aktualisht, "Për regjistrimin dhe trajtimin e nxënësve që kthehen nga emigracioni", MAS ka parashikuar një paketë trajtimi për secilin prej tyre, ku do të punohet me plane individuale mësimore në mënyrë që të plotësohen mangësitë në programet lëndore. Çdo nxënës do të vlerësohet nëse ka nevojë për kurse për mangësitë në gjuhën shqipe, brenda 30 ditëve nga paraqitja e nxënësve në shkollë. Për nxënësit që kthehen nga emigracioni do iu ofrohen kurse falas të gjuhës shqipe në shkollë, kur kjo vlerësohet nga institucioni shkollor ose kur kërkohet nga vetë prindërit/kujdestari i nxënësit. Institucionet arsimore do të mundësojnë pajisjen e nxënësve të regjistruar me tekste shkollore.
150. Gjithashtu, në kuadër të këtij procesi njësia e shërbimit psiko social në DAR/ZA po hartojnë plane të posaçme pune për ofrimin e shërbimeve që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve që kthehen nga emigracioni në përshtatshmërinë e tyre me shkollën, në marrëdhëniet mes komunitetit të nxënësve, si dhe në marrëdhëniet mes tyre dhe personelit mësimdhënës. Gjithashtu drejtuesit dhe mësuesit e shkollave janë udhëzuar që nxënësve të kthyer ose atyre që vijojnë të jenë ende në emigracion, të mos u pasqyrohen mungesat.
151. Kurrikula e veçantë për mësimin plotësues të gjuhës shqipe është hartuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit përmes Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA) Gjatë këtij procesi po mbahen parasysh diferencat e mundshme të shkollës jashtë vendit, në vendet kryesore të destinacionit të emigrantëve shqiptarë, me programet që ofron sistemi arsimor shqiptar. Në shkollat verore po marrin pjesë edhe kjo kategori fëmijësh, për mësimin plotësues të gjuhës shqipe.
152. Gjithashtu, për të adresuar interesat e vecanta të fëmijëve të shtetasve shqiptarë që kthehen në vend është punuar për mbështetjen e riintegrimit të tyre në sistemin arsimor të përgjithshëm dhe profesional, përmes informacionit dhe shërbimeve. Për këtë janë përcaktuar në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore detyrat për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer.
153. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, në planin vjetor të punës kanë përfshirë edhe detyrat për fëmijët e kthyer. Sektori i Statistikës evidenton dhe raporton periodikisht në MAS për ardhjen dhe sistemimin në institucionet e arsimit parauniversitar të fëmijëve të shtetasve

shqiptarë të ripranuar. Sektori i Kurrikulave dhe Cilësisë do të ketë të gatshme programet mësimore në ndihmë të këtyre fëmijëve duke evidentuar të gjitha nevojat sipas grup moshave.

154. Në periudhën *qershor 2010 – dhjetor 2012* janë sistemuar në institucionet e arsimit parauniversitar 4064 fëmijë të shtetasve shqiptarë të kthyer. *Në vitin shkollor 2013 – 2014* janë regjistruar për herë të parë në institucionet e arsimit parauniversitar 1628 fëmijë shqiptarë të lindur jashtë vendit. Në këtë vit shkollor janë regjistruar në sistemin arsimor parauniversitar për të vazhduar studimet e nisura jashtë vendit 2062 shtetas shqiptarë të kthyer. Gjithashtu, në këtë vit shkollor janë regjistruar në arsimin parauniversitar 36 fëmijë të shtetasve shqiptarë të ripranuar. *Në vitin shkollor 2014 – 2015* janë regjistruar në institucionet e arsimit parauniversitar 4504 fëmijë shqiptarë të kthyer.

155. Këtë vit shkollor janë regjistruar për të vazhduar studimet e nisura jashtë vendit 3000 fëmijë të shtetasve shqiptarë të kthyer. Në arsimin parauniversitar janë regjistruar 386 fëmijë të shtetasve shqiptarë të ripranuar. Gjithashtu në këtë vit shkollor, kanë aplikuar për ekuivalentimin e dëftesave dhe të dokumentacionit shkollor të marrë jashtë shtetit 4010 shtetas shqiptarë të kthyer.

Të dhëna mbi numrin e nxënësve deri në tetor të vitit 2015:

Nr.	Dar/Za	Arsimi bazë	Arsimi i mesëm
1	Berat	20	17
2	Bulqizë	8	0
3	Delvinë	4	0
4	Devoll	6	2
5	Dibër	8	3
6	Durrës	106	16
7	Elbasan	74	21
8	Fier	96	7
9	Gramsh	8	1
10	Gjirokastër	8	0
11	Has	9	0
12	Kamzë	60	11
13	Kavajë	46	6
14	Kolonjë	7	1

15	Korçë	17	19
16	Krujë	20	12
17	Kuçovë	4	2
18	Kukës	11	7
19	Kurbin	3	2
20	Lezhë	29	2
21	Librazhd	0	3
22	Lushnje	14	5
23	Malësi e Madhe	17	7
24	Mallakastër	3	0
25	Mat	8	11
26	Mirditë	5	1
27	Peqin	10	2
28	Përmet	6	0
29	Pogradec	13	8
30	Pukë	9	0
31	Sarandë	14	3
32	Skrapar	2	0
33	Shkodër	160	34
34	Tepelenë	7	2
35	Tiranë Bashki	383	19
36	Tiranë Rreth	15	2
37	Tropojë	6	3
38	Vlorë	45	77
	Total	1261	306

156. Referuar tabelës së mësipërme, numri total i nxënësve me prindër emigrantë të ardhur nga emigrimi deri në tetor të vitit 2015 është në total 1261 në arsimin bazë dhe 306 nxënës në arsimin e mesëm. Vërejmë se në qarkun, Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, shifrat e emigrimit janë të larta.

157. Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) në procesin e hartimit të kurrikulave të reja ka patur në konsideratë edhe përshtatjen e tyre me nevojat e emigrantëve të kthyer.
158. Janë organizuar shkolla verore ku kanë marrë pjesë edhe kategoria e fëmijëve të shtetasve shqiptarë të kthyer, për mësimin plotësues të gjuhës shqipe. Në periudhën *qershor 2010 – dhjetor 2012* janë hapur 10 shkolla verore, në të cilat kanë marrë pjesë 192 nxënës.
159. Fëmijëve të kthyer, në rastet kur ka qenë e nevojshme iu është ofruar shërbim psikologjik në sistemin arsimor për përshtatshmërinë e tyre me shkollën, në marrëdhëniet mes komunitetit të nxënësve si dhe në marrëdhëniet mes tyre dhe personelit mësimdhënës. *Në periudhën qershor 2010 – qershor 2015* është trajnuar stafi që ofron shërbim psikologjik në drejtoritë rajonale arsimore në zyrat arsimore dhe në shkolla. Në *periudhën qershor 2010 – dhjetor 2012* kanë marrë shërbim psikologjik 1330 nxënës, fëmijë të shtetasve shqiptarë të kthyer.
160. *Në periudhën janar 2014 – dhjetor 2014* u miratua Urdhri i Përbashkët i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për marrjen e masave për pritjen dhe trajtimin social e të miturve të pashoqëruar që kthehen ose ripranohen nga vendet e tjera. Në këtë urdhër të përbashkët janë përcaktuar detyrat e secilës palë para dhe pas kthimit të fëmijëve nga migracioni.
161. Nga Shërbimi Social Shtetëror realizohen vlerësimet social – ekonomike të familjeve para rikthimit të fëmijës në familjen biologjike, si dhe janë pritur në pikat kufitare dhe janë shoqëruar për në familjet e tyre fëmijët e riatdhesuar. Punonjësit socialë të Shërbimit Social Shtetëror kanë ndjekur riintegrimin e fëmijës së riatdhesuar në familje. Nga Shërbimi Social Shtetëror për riintegrimin e tyre është ofruar mbështetje shëndetësore, edukimi, dhe strehimi kur është paraqitur nevoja në institucione rezidenciale për fëmijë. Në këtë periudhë Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar vlerësimet social-ekonomike të 11 familjeve biologjike të fëmijëve para rikthimit të tyre si dhe janë pritur në pikat kufitare dhe janë shoqëruar për në familjet e tyre 6 raste, fëmijë të riatdhesuar.

Për arsimimin në gjuhën shqipe të fëmijëve dhe studentëve shqiptarë në diasporë:

Janë hartuar dhe miratuar:

162. Programi i Integruar i Mësimit Shqip në Diasporë" (Urdhër Ministri, datë 06.10.2010) mbi bazën e të cilit janë hartuar tre tekste të integruara "Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare", që së bashku me Abetaren mbarëkombëtare mbulojnë mësimin shqip në diasporë për grupmoshën 6-15 vjeç.
163. Furnizimi i shkollave shqipe me tekste shkollore (VKM nr. 212, datë 16.03.2011). Për të siguruar këto tekste shkollore, procedurat e blerjes realizohen nga MAS bazuar në procedurat e konkurrimit të hapur me shtëpitë botuese.
164. Një hap shumë i rëndësishëm është hartimi i programit mësimor për fëmijët shqiptarë në diasporë si, shtypja dhe shpërndarja falas e librave për këtë kategori nxënësish, përmes përfaqësive tona diplomatike.

165. Në zbatim të Marrëveshjes midis UT dhe Universitetit "Aristoteli" të Selanikut në shkurt 2014 është hapur programi i studimit të gjuhës shqipe pranë këtij të fundit.
166. Për aftësimin, kualifikimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënësve të gjuhës shqipe në diasporë çdo vit organizohet Seminari Mbarëkombëtar "Për mësimin plotësues të gjuhës shqipe në diasporë", aktivitet i përbashkët mes dy ministrive: Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në Shqipëri dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë.
167. Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë", grupet e përbashkëta të punës janë në proces draftimi të:
    1. Kurrikulës së përbashkët për mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë;
    2. Standardeve të mësuesit në diasporë dhe mërgatë;
    3. Marrëveshjes midis dy vendeve dhe ratifikimin e saj nga Kuvendi/Parlamenti i dy vendeve.

Rekomandimi nr. 42. ***Informacione rreth masava të ndërmarra për luftën kundër trafikimit dhe parandalimit të trafikut të fëmijëve dhe grave si dhe masa në mbrojtje të tyre.***

168. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.814, datë 26.11.2016 "Për një shtesë në vendimin 663, datë 17.07.2013 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013-2020 dhe Planit të Veprimit 2013-2016, u miratua Strategjia për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Plani i Veprimit për 2014-2017, e cila është duke u monitoruar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik dhe duke u implementuar nga strukturat përkatëse të ngritura posaçërisht për këtë qëllim nga nivelet më të larta politike, teknike si edhe operacionale.
169. Task Forca Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TF) është themeluar për herë të parë në 11/11/2013, në përputhje me Mekanizmin Kombëtar të Referimit (MKR) të rishikuar dhe është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit efektiv të MKR-së. Ajo drejtohet nga Koordinatori Kombëtar Antitrafik dhe përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë të institucioneve palë në këtë marrëveshje.
170. Struktura e referimit në nivel qendror e njohur si Autoriteti Përgjegjës, i përbërë nga përfaqësues të policisë, shërbimeve sociale, shëndetësisë, arsimit dhe autoritetet konsullore gjithashtu është i zgjeruar për një koordinim më të mirë lidhur me referimin për asistencën primare, mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit në të gjithë vendin. Autoriteti Përgjegjës vepron si një MKR për rastet e viktimave të trafikimit, në nivel kombëtar dhe lokal. Qëllimi i MKR-së është për të identifikuar dhe mbrojtur çdo viktimë të trafikimit të shfrytëzuar brenda ose jashtë vendit.

171. Në lidhje me përmirësimin e shërbimeve për viktimat e trafikimit dhe mbrojtje më të mirë në 2014 për herë të parë, viktimat e trafikimit janë të pajisur me shërbim shëndetësor falas.
172. Bazuar në ndryshimet e fundit në ligjin për fondet e sigurimeve shoqërore, Fondi i mbulon shpenzimet për barna, kontrolle mjekësore dhe trajtime mjekësore në spitale private ose publike, të kontraktuara nga Fondi, për të gjitha viktimat e trafikimit.
173. Viktimat e trafikimit konsiderohen si një grup në nevojë. Numrin e përafërt të viktimave të parashikuara për të përfituar nga ky shërbim është 200 dhe ata do të vazhdojnë të përfitojnë kujdes mjekësor falas, edhe pas largimit nga skema e ndihmës ekonomike. Gjithashtu, ligji i ri "Për policinë e shtetit", korrik 2014, ofron garanci ligjore shtesë për mbrojtje më të mirë dhe mbështetje për viktimat e trafikimit, në veçanti fëmijëve.
174. Ky ligj, ndër detyrat e policisë së shtetit, parashikon në nenin 17 (g), identifikimin, mbrojtjen dhe referimin për ndihmë tek autoritetet përkatëse të viktimave të trafikimit. Kurse në nenin 123, masat që do të merren nga policia e shtetit janë të specifikuara për mbrojtjen e të miturve, duke vendosur si përgjegjës direkt zyrtarët e policisë së shtetit, për të asistuar dhe referuar, kur vlerësohet e nevojshme, për fëmijët e braktisur apo të larguar nga shtëpitë e tyre
175. Gjithashtu, Koordinatorja Kombëtare Antitrafik është duke punuar së bashku me Ministrinë e Financave në drejtim të zbatimit efektiv të ligjit Anti-mafia me mbështetjen e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik.
176. Në bazë të ligjit nr. 141/2014 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është aktivizuar shërbimi shëndetësor falas për viktimat / viktimat e mundshme të trafikimit, duke u dhënë atyre rast pas rasti karta shëndetësore. Deri në mars të vitit 2016 një total prej 44 viktima / viktima të mundshme të trafikimit kanë fituar kartat shëndetësore.
177. Në janar 2016, u krijua Zyra e Ndihmës për Viktimat duke pasur në fokus të veçantë të punës së tyre viktimat të cilat janë të mitur ose personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, viktima të dhunës apo shfrytëzimit seksual, trafikimit etj.
178. Në 19 qershor 2015, u nënshkrua Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e viktimave të trafikimit dhe viktimave potenciale. Gjatë periudhës së raportimit, takime periodike të anëtarëve të Autoritetet Përgjegjës janë mbajtur, për të trajtuar raste të veçanta të viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit.
179. Në 21 tetor 2014, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore "Për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin e punës së të tjerëve".
180. Me Vendimin Nr 115 datë 17.02.2016 është miratuar Plani i Veprimit për Ri-integrimin Social dhe Ekonomik të grave dhe vajzave viktima të trafikimit. Ky Plan Veprimi ndihmon në zhvillimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave VT / VMT në fushën e fuqizimit

ekonomik, p.sh. të drejtat e pronës, punësimit dhe trajnimit profesional, strehimin, arsimi dhe kujdesi social.

181. Për vitin 2015, një fond prej 2,555,000 lekësh është ndarë për qendrat e "Other Vision", "Different but Equal" dhe "Vatra". Qeveria shqiptare ka ofruar mbështetje financiare për punësimin e 12 punëtorëve socialë në qendrat "Other vision" dhe "Vatra".
182. Qeveria vazhdon të ofrojë ndihmë ekonomike për viktimat e trafikimit pas daljes së tyre nga qendra, sipas Vendimit nr. 796, datë 08.09.2010 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 787, datë 14.12.2005 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe masave për ndihmën ekonomike", të ndryshuar.
183. Për vitin 2016, u miratua dhe janë ndarë fonde nga buxheti i shtetit për të mbuluar pagat e 24 punonjësve socialë të qendrave të menaxhuar nga OJQ-të.
184. Në qershor të vitit 2014, në bashkëpunim me World Vision dhe Vodafone, është lançuar Linja Kombëtare e Kontaktit 116 006 dhe aplikimi "Njoftoni! Shpëto". Ky shërbim linjë kontakti ofrohet falas për publikun për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit.
185. Drejtoria e Anti-Trafikimit, gjatë periudhës së verës (qershor- shtator 2015) filloi një fushatë kombëtare për parandalimin e trafikimit, ku institucionet shtetërore dhe jo shtetërore, partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, morën pjesë në organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese, në forumet e diskutimeve, në konferenca lokale dhe kombëtare, në marshime dhe shfaqje televizive.
186. Në kuadër të Ditës Evropiane të Anti-Trafikimit (18 tetor), Drejtoria e Anti-trafikimit në bashkëpunim me organizatat dhe institucionet partnere, në vitin 2014 organizoi "Javën e Anti-trafikimit" dhe në vitin 2015 ësthë organizuar gjatë muajit tetor "Muaj për Luftën kundër Trafikimit të Personave".

Rekomandimi nr. 44. ***Komiteti rekomandon që Shteti palë të rrisë përpjekjet që luftojnë kontrabandën e migracionit, veçanërisht të grave e fëmijëve, ndër të tjera duke bërë hapa të nevojshëm për zbulimin e lëvizjeve ilegale ose klandestine të punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre dhe sjelljen e tyre para drejtësisë.***[4]

[4] Referim përgjigjes mbi rekomandimin nr. 42 si më lart.

VENDIM
Nr. 846, datë 7.12.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË POLICISË SË SHTETIT PËR MENAXHIMIN ELEKTRONIK TË GJOBAVE (E-GJOBA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", dhe të nenit 127, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Policisë së Shtetit për Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Gjobave (E-gjoba).

2. Institucioni administrues i Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Gjobave (E-gjoba) është Policia e Shtetit.

3. Dhënësi i informacionit për këtë sistem është Drejtoria e Financës, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

4. Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Gjobave ka për qëllim automatizimin e procesit të administrimit të gjobave si dhe përqendrimin e të dhënave të gjobave, për të gjitha njësitë e Policisë Rrugore, duke i ofruar organeve përkatëse informacion të saktë dhe të shpejtë mbi:

a) gjendjen e gjobave të një mjeti (paguar/pa paguar), së bashku me të dhënat e mjetit;

b) historikun e mjetit dhe të veprimtarisë së plotë të përdoruesit;

c) raporte për gjobat, agjentin, vendimet e komisionit, mjetin, operatorët;

ç) statistika për gjendjen e gjobave, performancën e operatorit dhe pasqyrën e rezultateve;

d) plotësimin e një gjobe të re me të dhënat e punonjësit që vendos gjobën dhe të dhënat e shkelësit të dispozitave të Kodit Rrugor.

5. Të dhënat parësore të Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Gjobave (E-gjoba) janë të dhënat e gjobës në të cilën vendoset numri serial i gjobës, koha e vendosjes së gjobës, vendndodhja, vlera e gjobës, shuma dhe arsyeja e vendosjes së gjobës.

6. Të dhënat dytësore janë të dhënat që merren nga:

a) DPSHTRR-ja, si: targa e mjetit, modeli i mjetit, shasia, pronari si dhe të dhënat për lejen e drejtimit dhe historikun e zotëruesit, të dhënat e plota të regjistrimit të mjetit dhe drejtuesit e mjeteve (pronar dhe përdorues);

b) sistemi i RMIS (Sistemi i Menaxhimit të Burimeve të Brendshme të Policisë së Shtetit), emër/mbiemër i punonjësit të Policisë që vendos gjobën, funksioni, struktura organizative ku ky punonjës bën pjesë, grada.

7. Baza e të dhënave E-gjoba ndërvepron me:

a) sistemin e DPSHTRR-së, ku merren të dhënat e mjeteve në bazë të targës (Targa, modeli, shasia, pronari etj.);

b) sistemin RMIS (Sistemi i Menaxhimit të Burimeve të Brendshme të Policisë së Shtetit), ku merren të dhënat e punonjësit të Policisë që vendos gjobën (emër, mbiemër, struktura organizative së cilës i përket).

8. Shtetasi ka nivel aksesi vetëm për konsultimin e informacioneve të vëna në dispozicion, nëpërmjet faqes së internetit të Policisë së Shtetit, www.asp.gov.al, (rubrika Shërbime/ Kontrolloni gjobat tuaja).

9. Për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, niveli i aksesit, përcaktohet në rregulloren e brendshme të bazës të të dhënave shtetërore të E-gjoba, e cila miratohet me urdhër të drejtorit të Policisë së Shtetit.

10. Sistemi E-gjoba ka 6 nivele përdoruesish:

a) Niveli "Gjobë" i përdoruesit;

b) Niveli "Raporte";

c) Niveli "Menaxhim";

ç) Niveli "Komision";

d) Niveli "Financë";

dh) Niveli "Supervizor".

11. Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës dhe përcaktohen në procedurat e punës, të cilat miratohen nga drejtori i Policisë së Shtetit për secilin punonjës.

12. Subjektet e interesuara për Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Gjobave (E-gjoba), janë, si më poshtë:

a) Policia e Shtetit;

b)Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF);

c) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR);

ç) Autoriteti Kombëtar i Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);

d) Institucionet financiare jobankare;

dh) Bankat e nivelit të dytë.

Aksesi i subjekteve të përcaktuara në këtë pikë, në Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Gjobave, është i kufizuar, sipas legjislacionit që rregullon veprimtarinë e tyre dhe qëllimin e përpunimit.

13. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të Sistemit E-gjoba të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane dhe ndërkombëtare, në fushën e standardizimit, do të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i bazës të të dhënave shtetërore për Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Gjobave (E-gjoba) përcaktohet në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës të të dhënave shtetërore, të miratuar nga drejtori i Policisë së Shtetit.

15. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 847, datë 7.12.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E KULTURËS (QENDRA NDËRKOMBËTARE E KULTURËS "ARBNORI") TE BASHKIA TIRANË, TË PRONËS ME NUMËR PASURIE 1/53, TË NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8160, ME SIPËRFAQE TRUALLI DHE NDËRTESE 4294 m², DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 286, DATË 8.8.1991, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E QENDRËS NDËRKOMBËTARE TË KULTURËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja "d", 5, 8, 17 e 18, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, të ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Kulturës (Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori") te Bashkia Tiranë, të pronës me numër pasurie 1/53, të ndodhur në zonën kadastrale 8160, me sipërfaqe trualli dhe ndërtese 4294 (katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) m^2, sipas planimetrisë bashkëlidhur, për t'u përdorur si qendër shumëfunksionale për organizimin e eventeve sociale, promovimin e artit, të kulturës dhe të teknologjisë.

2. Pika 2 e vendimit nr. 286, datë 8.8.1991, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës", shfuqizohet.

3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Kulturës, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, kryetari i Bashkisë Tiranë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama


FRAGMENT NGA PLANIMETRIA E TIRANËS, ZK. 8 140, TR; M-16, VITI 2016, SH.1:1000
QENDRA NDËRKOMBËTARE E KULTURËS
Porositës: D.P.J.A.L, BASHKIA E TIRANËS
Nr. Prot. 33907/2, Datë: 10/11/2016
BLV. "ZHANË D'ARK"
LUMI "LANËS"
BLV. "BAJRAM CURRI"
RRUGA "PAPA GJON PALI II"
BLV. "DËSHMORËT E KOMBIT"
1K8K
4K
1K5K
1K5K
3K
3K
4K
SHËNIME
GEN-PLANI SHOQËROHET GJITHMONË ME FRAGMENTIN E HARTËS NË SHKALLË 1:2000
KËRKESA PËR GENPLAN ËSHTË PËR "QENDRËN NDËRKOMBËTARE E KULTURËS"
PJESA E KONTURUAR ME VIJË TË NDËRPRERË ËSHTË PRONA E AZHORNUAR NË TERREN
REFERUAR STATUSIT JURIDIK TË PASURISË, TË KONFIRMUAR NGA ZYRA VENDORE E
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË, ME SHKRESËN ME NR. PROT. 33907/2,
DATË 10.11.2016, PRONA E AZHORNUAR NË TERREN REZULTON ME GJENDJEN JURIDIKE SI MË POSHTË:
PAS. NR. 1/54, "TRUALL" ME SIP. 23 737 M2, ME PRONËSI "SHTET"
PAS. NR. 1/53, "TRUALL" ME SIP. 4 294 M2, ME PRONËSI "QENDRA NDËRKOMBËTARE E KULTURËS"
PAS. NR. 1/44, "TRUALL" ME SIP. 185 M2, ME PRONËSI "SHTET"
PAS. NR. 1/37, "TRUALL" ME SIP. 492 M2, ME PRONËSI TË Z. KLITIM KOKOSHI
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DITJON BABOÇI
DREJTORIA E GIS-KADASTRËS
PËRGJ.I SEKTORIT GIS-KADASTRËS URBANE
MERITA QIRJAKO
Datë: 14/11/2016
AZHORNOI
AUREL XHUVELI
FREDI PAPULI

VENDIM
Nr. 848, datë 7.12.2016

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË "ALBGAZ" SHA DHE PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT PUBLIK QË PËRFAQËSON SHTETIN SI PRONAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE "ALBPETROL" SHA DHE "ALBGAZ" SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 36, pikat 2 e 5, 50, pikat 2 e 4, 57 e 80, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", dhe të nenit 4, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkëputjen e njësisë së gazit nga shoqëria "Albpetrol" sh.a. dhe krijimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., me kapital 100 % shtetëror.

2. Shoqëria "Albgaz" sh.a., duhet të funksionojë si një operator i kombinuar duke kryer veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të gazit natyror.

Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., të jetë 359 068 000 (treqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë. Kjo vlerë e kapitalit fillestar përfaqëson vlerën me të cilën do të zvogëlohet kapitali i shoqërisë "Albpetrol" sh.a., pas shkëputjes së njësisë së gazit, në përputhje me urdhrin nr. 550/3, datë 5.5.2016, të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, "Për sistemimin e kapitalit të Albpetrol sh.a.".

3. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë "Albgaz" sh.a., është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

4. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron të drejtat mbi shoqërinë "Albgaz" sh.a., në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", dhe fushën e tij të përgjegjësisë shtetërore.

5. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë "Albpetrol" sh.a., është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

6. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministri i Energjisë dhe Industrisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjekin procedurat e nevojshme, për:

a) regjistrimin e zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a., transferimin e vlerës së kapitalit të zvogëluar te shoqëria "Albgaz" sh.a., si dhe përmbylljen e procedurave për regjistrimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

b) emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërive "Albgaz" sh.a. dhe "Albpetrol" sh.a., duke respektuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

7. Me regjistrimin në QKB, shoqëria "Albgaz" sh.a., të aplikojë pranë Entit Rregullator të Energjisë për certifikim, si operator transmetimi, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", si dhe për pajisjen me licencë për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 22, 23 dhe 24, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

8. Aktiviteti i shoqërisë "Albgaz" sh.a., për periudhën nga krijimi i saj deri më 31 dhjetor 2017, të financohet nëpërmjet fondeve që do të sigurohen nga marrëveshja e huas, e lidhur me shoqërinë "Albpetrol" sh.a. dhe/ose fondet që siguron mbi bazën e marrëveshjeve me institucione financiare dhe/ose donatorë vendas apo ndërkombëtarë.

9. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe shoqëria "Albpetrol" sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KORRIGJIM GABIMI

Në vendimin nr. 756, datë 26.10.2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 205/2016, datë 3.11.2016, faqe 22119, bëhet korrigjimi:

Në pikën 3, shkronja "a", fjalia e parë

është: "shkel distancat nga kufiri rrugor i rrugëve ekzistuese të kategorive A e B ose **trupi i** rrugëve ekzistuese të kategorive C, D dhe E",

bëhet: "Shkel distancat nga kufiri rrugor i rrugëve ekzistuese të kategorive A e B ose **trupin e** rrugëve ekzistuese të kategorive C, D dhe E".

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot"
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 322 lekë